

65918

Evropa Juglindore Raporti i Zhvillimeve Ekonomike

Raporti Kryesor

Speciale:

Aftësi, jo thjesht diploma

Kërkimi&Zhvillimi dhe Inovacioni



Njësia për Reduktimin e Varfërisë dhe Manaxhimin Ekonomik
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

15 nëntor 2011



Ky raport është përgatitur nga një ekip udhëhequr nga Ron Hood (rhood@worldbank.org) dhe duke përfshirë Erjon Luçi, Damir Cosic, Borko Handjiski, Agim Demukaj, Sanja Madzarevic-Sujster, Evgenij Najdov, Danijela Vukajlovic-Grba dhe Dushko Vasiljeviç.

Speciale # 1 ‘Aftësi, jo thjesht diploma’ është përgatitur nga Lars Sondergaard dhe Speciale # 2 ‘K&Zh dhe inovacion’ nga Paulo Correa dhe Dragana Pajovic.

EJL6 i referohet Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia.

PËRMBLEDHJE

Rimëkëmbja i rritjes globale që nisi në vitin 2010 filloi të zbehej gjatë vitit 2011. Gjatë gjysmës së parë rënia u lidh me katastrofën bërthamore të Tohoku-t në Japoni dhe cmimet e larta të naftës. Por nga fundi i muajit korrik efektet e përkohshme të Tohoku-t kishin nisur të zbeheshin dhe prodhimi global industrial po rritej. Megjithatë, qysh nga muaji gusht ekonomia globale po përjeton një presion në rritje nga problemet e borxhit sovran në Evropë, nga rritja ekonomike anemike e SHBA-së dhe nga ngadalësimi ekonomik i Kinës dhe i tregjeve të tjera në lindje. Treguesit më të fundit dhe parashikimet ekonomiko-financiare flasin për një ngadalësim të mëtejshëm të rritjes ekonomike në Evropë. Ndërkaq vazhdojnë të mbeten rreziqet e një recesioni të dytë në SHBA dhe një ngadalësimi të ndjeshëm të ekonomive të mëdha në zhvillim.

Zhvillimet ekonomike afatshkurtra për EJL6¹ varen ndjeshëm nga faktorë që janë kryesisht përtej kontrollit të qeverive të vendeve të EJL6. Në kohën e hartimit të këtij dokumenti, liderët e vendeve kryesore të BE-së ende po përpiqen të zbatojnë një grup politikash të besueshme për të arritur një proces të rregullt të menaxhimit të borxhit të Greqisë, për të parandaluar rreziqet e përhapjes së tij në ekonomitë e tjera të Eurozonës, për të siguruar rikapitalizimin e bankave të prekura nga shkurtimi i mundshëm i borxheve sovraane, si edhe për krijimin e një kuadri fiskal më të unifikuar dhe me efektiv fiskal për vendet e Eurozonës (EA). Pasiguria në lidhje me mundësinë e përmbjlljes me sukses të këtij procesi, si edhe e një sërë uljesh vlerësimi të borxheve, volatiliteti i bursave dhe pasiguria në lidhje me politikat e deficitit në SHBA ka tronditur besimin e investitorëve dhe të biznesit dhe i ka bërë konsumatorët mosbesues. Një numër më i madh analistësh i ka ulur parashikimet për rritjen globale në SHBA dhe në BE me një pikë përqindje ose më shumë. Parashikimet tona për rritjen ekonomike për vendet e EJL6 janë 2.5 përqind në vitin 2011 dhe 2.1 përqind në vitin 2012, që do të thotë shumë më të ulëta sesa ato përpara vitit 2008 me 6-10 përqind. Edhe këto parashikime modeste për rritjen ekonomike kanë në bazë të tyre supozimin që liderat evropianë janë në gjendje ta zgjidhin krizën duke shmangur një falimentim të ç'rregullt dhe përhapjen e saj. Megjithatë, në rast se hartuesit e politikave dështojnë dhe kriza përkeqësohet, performanca e vendeve të EJL6 dhe e pjesës tjetër të globit mund të jetë edhe më negative.

Tabela 1: ritmet e rritjes reale te PBB-së në EJL6 (%)

	2007	2008	2009	2010	2011	2012
				Vle.	Proj.	Proj.
Shqipëria (ALB)	6.0	7.7	3.3	3.5	3.0	2.0
Bosnjë dhe Hercegovina (BIH)	6.8	5.7	-3.1	0.8	2.0	1.0
Kosova (KOS)	6.3	6.9	2.9	4.0	5.3	5.0
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (MKD)	6.1	5.0	-0.9	1.8	3.0	2.5
Mali i Zi (MZI)	10.7	6.9	-5.7	2.5	2.9	2.0
Serbia (SRB)	5.4	3.8	-3.5	1.0	2.0	3.0
EJL6	6.8	5.9	-1.7	2.0	2.5	2.1

Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave dhe parashikimet e stafit të BB.

¹ Në vendet e EJL6 përfshihen: Shqipëria, Bosnje- Hercegovina, Kosova, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia.

Efektet e një ngadalësimi të mëtejshëm global dhe thellimit të krizës së eurozonës do t'u përcillen vendeve të EJL6 përmes disa kanaleve. Vendet e BE-së dhe ato të Eurozonës (EZ), në veçanti, janë ndër partnerët më të rëndësishëm tregtare për të gjitha vendet e EJL6: tregtia me BE-në është nga 30 përqind deri në pothuajse gjysmën e PBB-së të vendeve të EJL6. Përtej tregtisë, BE-ja është gjithashtu burimi më i lartë në agregat i Investimeve të Huaja Direkte (IHD) për rajonin, ku vlera neto e prurjeve të IHD-ve e kalon 2 përqindshin e PBB të Ballkanit Perëndimor. Prania e bankave të huaja krijon një tjetër kanal të rëndësishëm të transmetimit potencial të krizës së eurozonës në vendet e EJL6: jo vetëm që përqindja e bankave të huaja në totalin e aktiveve në sistemin bankar të rajonit është shumë e lartë (afërsisht 89 përqind e totalit), por kjo prani e huaj në disa raste përfshin financime të konsiderueshme të huaja të aktivitetit të këtyre bankave. BE-ja është gjithashtu një burim shumë i rëndësishëm i remitancave (dërgesave të emigrantëve) për rajonin. Të gjitha këto kanale transmetimi do të ndikohen nga thellimi i tensioneve ekonomiko-financiare të BE-së dhe Eurozonës.

Aktualisht, sistemet bankare në vendet e EJL6 duken të qëndrueshme, me nivel të lartë likuiditeti dhe rezerva të larta kapitali, por kjo mund të ndryshojë papritur, sidomos për disa banka specifike. Rajoni i EJL6 karakterizohet nga një përqindje relativisht të lartë të bankave me pronësi greke dhe italiane. Bankat austriake gjithashtu kanë një prani të rëndësishme në rajon, ndonëse këto banka përballen me më pak rreziqe të borxhit sovran. Duke patur parasysh kërkesën e BE për rritjen e kapitalit të bankave, një trysni e mëtejshme mbi fondet e bankave përkatëse mëma mund të çojë në një presion mbi bankat e huaja për të siguruar likuiditet apo dividende për bankat mëmë. Për më tepër, qysh nga viti 2009 ka patur një rritje të shpejtë të huave me probleme (NPLs) në të gjitha vendet e EJL6. Qysh nga ajo periudhë, huatë me probleme janë stabilizuar në disa por jo në të gjitha vendet duke mbetur ende shumë lartë niveleve të tyre të para krizës. Këta faktorë mund të shkaktojnë një tjetër ngërç kredie në rajon. Nga ana tjetër, bankat e huaja aktualisht duken likuide dhe me kapital të mjaftueshëm. Gjithashtu, pjesa më e madhe e tyre janë banka dhe jo degë dhe rrjedhimisht janë objekt i monitorimit dhe rregullimit të mbikëqyrësve të vendeve të EJL6. Gjithashtu, niveli i përgjithshëm i vartësisë nga financimet e huaja të bankave të EJL6 është më i ulët nga ai i vendeve të EU10-ës.² Kjo reflekton pjesërisht vartësinë për fonde të bankave me pronësi të huaja në vendet e EJL6-ës nga depozitat vendase. Aktualisht nuk ka ndonjë të dhënë për tërheqje depozitash, si ato që shoqëruan krizën e vitit 2008, ndërkohë që situata ka nevojë për një monitorim të kujdesshëm. Megjithatë, financimet e huaja përbëjnë një burim të rëndësishëm në fondet e bankave për financimin e sektorit real, duke qenë se huamarrja e huaj direkte nga sektori real në vendet e EJL6 arrijnë afërsisht 18 përqind të PBB-së. Prurjet nga investimet e huaja direkte (IHD) dhe portofoli, përbëjnë një burim më të qëndrueshëm financiar. Megjithatë, investimet e huaja direkte në vendet e EJL6 janë ngadalësuar qysh nga gjysma e dytë e vitit 2008 dhe tashmë janë në nivelin 60 përqind të nivelit të para krizës.

Situata fiskale mbetet e brishtë dhe autoriteteve u duhet të rigjenerojnë rezervat fiskale dhe të jenë të përgatitura për konsolidim të mëtejshëm të të ardhurave në rast mosplotësimi apo mospërmbushje të parashikimeve për të ardhurat si rrjedhojë e përkeqësimit të kushteve globale. Gjatë viteve të fundit, vendet e EJL6 i ezauruan rezervat modeste të krijuara gjatë periudhës së para krizës, kur pati një rritje të lartë ekonomike dhe të ardhura të begata. Me përjashtim të Kosovës, asnjë vend tjetër nuk ka depozita të mjaftueshme për t'i përdorur në rast nevoje. Për më tepër, tregjet e kapitaleve vendase janë të vogla e ndërsa bankat duket se kanë aktualisht pozicione të mira likuiditeti, kjo situatë mund të ndryshojë shumë shpejt në rast të një ngadalësimi më të theksuar të aktivitetit ekonomik. Për më tepër, aksesit në tregjet e jashtme financiare do të mbetet i vështirë për vendet e EJL6 në periudhën që do të vijë. Kjo do të thotë që vetëm pak nga vendet e EJL6 do të kenë ende mundësi për t'i bërë ballë një përkeqësimi të krizës përmes stimuljeve fiskale apo përmes stabilizatorëve automatikë, ndërsa disa vendeve do t'u duhet të përshpejtojnë konsolidimin fiskal, në veçanti të reformave që forcojnë

² Anëtarët e rinj të Bashkimit Evropian


qëndrueshmërinë afatgjatë fiskale. Po ashtu, politikat monetare në disa prej vendeve të EJL6 kanë hapësirë të kufizuar veprimi për shkak të regjimit të kursit të shkëmbimit që kanë adaptuar.

Është e rëndësishme të mbahet parasysh fakti që, pavarësisht nga kriza e kohëve të fundit, modeli i rritjes ekonomike i bazuar në thellimin i procesit të integritit me BE-në në drejtim të financave, tregtisë, tregjeve të punës dhe institucioneve mbetet modeli më i mirë për vendet e EJL6 në periudhën afatgjatë. Dy janë mësimet bazë të ngjarjeve më të fundit që do t'u bëjnë të mundur vendeve të EJL6 të shfrytëzojnë më mirë përfitimet e këtij modeli të rritjes ekonomike. Mësimi numër një është që në të ardhmen rritja ekonomike do të bazohet më shumë nga investimet dhe përmirësimet e produktivitetit që rrisin konkurrueshmërinë dhe kapacitetet prodhuese dhe më pak nga konsumi i financuar nga jashtë dhe nga investimet në pasuri të paluajtshme dhe flluska të tjera aktive që karakterizuan periudhën përpara vitit 2009. Mësimi numër dy është që për pjesën më të madhe të vendeve të EJL6 mbetet një program i gjatë i papërfunduar i reformave strukturore. Këto reforma duhen adresuar sa më shpejt për të përfituar aksesin në tregje, investimet e huaja direkte, financimet bankare dhe remitancat që ofron modeli i rritjes ekonomike i bazuar tek integriti.

1. ZHVILLIMET GLOBALE

Rikuperimi i rritjes globale që nisi në vitin 2010 filloi të dobësohet në 2011. Gjatë gjysmës së parë të rënies që u lidh me katastrofën bërthamore të Tohoku-t në Japoni dhe cmimet e larta të naftës, por nga fundi i muajit korrik efektet e përkohëshme të Tohoku-t kishin nisur të zbeheshin dhe prodhimi global industrial po rritej. Megjithatë, qysh nga muaji gusht ekonomia globale po përjeton një stres në rritje nga problemet e borxhit sovran Evropë, nga rritja ekonomike anemike e SHBA-së dhe nga ngadalësimi ekonomik i Kinës dhe tregjeve të tjera në lindje. Treguesit më të fundit dhe parashikimet ekonomiko-financiare flasin për një ngadalësim të mëtejshëm të rritjes ekonomike në Evropë. Ndërkaq vazhdojnë të mbeten risqet e një recesioni të dyfishtë në SHBA dhe një ngadalësim më të ndjeshëm në BRICs.³ Në vendet në zhvillim të Evropës, rritja ekonomike gjithashtu parashikohet të bjerë gjatë vitit 2012.


Figura 1: Ritmet e rritjes ekonomike botërore 2007-2011 (%)



Burimi: FMN WEO, shtator 2011.

Në vendet e eurozonës, kriza e besimit tashmë është përhapur përtej Greqisë, Irlandës dhe Portugalisë, ku spredet e sigurimit të kredive (CDS) në Itali dhe Spanjë janë rritur ndjeshëm gjatë javëve të fundit. Ndërsa problemet e bilancit të Greqisë, Irlandës dhe Portugalisë janë të mëdha për vetë këto

Figura 2: Norma 5 vjeçare CDS për disa vende të eurozonës



Burimi: Bloomberg.

Eurozonës prej 1.6 dhe 0.8 përkatësisht për vitin 2011 dhe 2012.

vende, ato janë të vogla për Eurozonën (ku borxhi publik është i barabartë me 6 përqind të PBB-së të Eurozonës). Ndryshe, borxhi publik i Spanjës dhe Italisë arrin në 27 përqind të PBB-së së Eurozonës.


Me këto pasiguri në rritje, ka gjasa që rritja ekonomike globale të jetë më e ulët gjatë viteve 2011-12 nga c'pritej në mes të vitit kur Banka Botërore publikoi parashikimet e saj më të fundit zyrtare. Për qëllimet e këtij raporti, ne do të supozojmë se rritja ekonomike globale prej 2.8 përqind gjatë viteve 2011-12 dhe ajo e

³ Brazil, Rusia, India dhe Kina

2. RITJA EKONOMIKE NË VENDET E EJL6⁴


Në vendet e EJL6, rritja ekonomike e para krizës varej nga një kërkesë vendase në lulëzim që financohej nga jashtë (Figura 5). Në vitin 2008, kërkesa e brendshme- kryesisht konsumi dhe në një shkallë më të ulët investimet - kontribuonin 7.6 pikë përqindjeje të të gjithë 5.1 përqindshit të rritjes ekonomike. Rrjedhimisht, eksportet neto kontribuonin negativisht në rritjen ekonomike (-2.9 pikë përqindjeje).

Figura 3: Rritja reale e PBB ne vendet e EJL6 (%)



Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave.

Figura 4: Rritja reale e PBB në vendet e EJL6, EU10 dhe EU 15 (%)




Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave dhe Eurostat.

Me fillimin e krizës së vitit 2009, kërkesa vendase pësoi një tkurrje dhe eksportet neto u shndërruan në të vetmin burim të rritjes ekonomike. Kërkesa vendase pësoi një rënie të ndjeshme për shkak të rënies së investimeve. Kjo çoi një kontraktim të importeve, të cilat u ngadalësuan më shumë sesa eksportet duke sjellë një kontribut pozitiv të eksporteve neto përkundrejt rritjes ekonomike (5.8 pikë përqindjeje). Si rajon, EJL6 përjetoi një recesion në vitin 2009 prej 1.7 përqind të PBB-së ose shprehur ndryshe një rënie prej 7.6 pikë përqindjeje nga rritja ekonomike e periudhës së para krizës në vitin 2008. Jo të gjitha vendet u prekën njësoj – Shqipëria dhe Kosova mundën të shmangnin recensionin, ndërsa Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë përjetoi një ngadalësim modest të rritjes ekonomike, kurse Mali i Zi, Serbia dhe Bosnje- Hercegovina përjetuan një recesion të fortë.

Rritja ekonomike nisi sërish në vitin 2010, ndonëse me një ritëm shumë më të ngadaltë sesa përpara krizës (1.6 përqind përkundrejt 5.1 përqind). Ndërsa rajoni përjetoi një rikuperim modest në vitin 2010 (1.6 përqind rritje të PBB), eksportet neto vijuan të qëndronin burimi i rritjes ekonomike duke kontribuar me 3.1 pikë përqindjeje, ndërsa kërkesa vendase vijoi të jetë një barrë për rritjen ekonomike (-1.7 pikë përqindjeje).


⁴ EJL6 përfshihen: Shqipëria (ALB), Bosnje- Hercegovina (BiH), Kosova (KOS), Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (MKD), Mali i Zi (MZI) dhe Serbia (SRB).

Figura 5: Kontributet ndaj rritjes reale te PBB (%)



Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave dhe përllogaritjet e stafit të Bankës Botërore.


Figura 6: Kontributet ndaj rritjes reale te GVA (%)



Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave dhe përllogaritjet e stafit të Bankës Botërore.

Nga pikëpamja e prodhimit (Figura 6), performanca përpara krizës karakterizohej nga një kontribut i fuqishëm i sektorëve të shërbimit dhe atij të ndërtimit, të cilët bashkërisht kontribuonin 3.4 pikë përqindjeje, bashkë edhe me industrinë dhe bujqësinë që përbënin pjesën tjetër të totalit prej 4.2 pikësh përqindjeje të rritjes të Vlerës së Shtuar Bruto (GVA). Megjithatë, gjatë recesionit, industria dhe ndërtimi ishin sektorët që u goditën më shumë, me një rënie prej 1.9 pikë përqindjeje, duke u përgjigjur kështu pothuajse plotësisht për rritjen negative të GVA-së së rajonit. Sektori i ndërtimit vijoi të pësonte rënie në perpidhën pas shfryrjes së të tregut të pronave të paluajtshme, ndërsa sektori i shërbimit (1 pikë përqindjeje) dhe ai i industrisë (0.3 pikë përqindjeje) sollën një kontribut pozitiv në totalin e 1.2 rritjes së përqindjes të GVA-së.

Figura 7: Prodhimi industrial, (janar 2008 = 100)



Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave, dhe llogaritje të stafit të BB


Vendet e EJL6 janë të prekshme ndaj efekteve të një ngadalësimi të mëtejshëm global dhe një thellimi të krizës të eurozonës (EA) në disa aspekte: tregti, investime të huaja direkte, bankat e huaja dhe remitancat. Vendet e BE-së dhe ato të eurozonës në veçanti janë partnerët më të mëdhenj tregtarë të të gjitha vendeve të EJL6, të cilat janë përgjithësisht ekonomi të hapura: tregtia me BE-në është e barabartë me 30 përqind dhe përbën pothuajse gjysmën e PBB-ve të vendeve të EJL6. Këto marrëdhënie të fuqishme tregtare theksohen edhe më nga një rrjet i “Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit” me BE-në të cilat liberalizuan ndjeshëm aksesin e tyre të tregtisë me BE-në. Përtej tregtisë, BE-ja është gjithashtu burimi më i madh në agregat i investimeve të huaja direkte neto për rajonin, me vlerë mbi 2 përqind të PBB-së të vendeve të EJL6.⁵ Bankat me pronësi të huaj përfaqësojnë një aspekt tjetër të rëndësishëm të transmetimit në potencë të krizës së zonës euro në vendet e EJL6: jo vetëm që përqindja e bankave të huaja në totalin e aktiveve të sistemit bankar të rajonit është shumë e madhe (afërsisht 89 përqind e totalit), por kjo prani e huaj është kryesisht një prani e zonës euro. BE-ja është gjithashtu një burim i rëndësishëm i remitancave në rajon. Të gjitha këto kanale transmetimi do të influencohen/preken nga tensionet më të thella ekonomiko-financiare të BE-së dhe eurozonës.

⁵ BE-ja gjithashtu garanton ekuivalentin e afërsisht 1 përqind të PBB-së të vendeve të EJL6 të fluksit të ndihmave zyrtare, ndonëse ato nuk preken nga zhvillimet ciklike.

3. ZHVILLIMET TREGTARE DHE ATO TË JASHTME

Integrimi progresiv i ekonomive të vendeve të EJL6 me ato të BE-së nënkupton se tregtia me vendet e BE-së është një ndër shtytat kryesore të performancës së eksporteve dhe rritjes ekonomike në përgjithësi në vendet e EJL6. BE-ja është tregu kryesor i eksporteve për vendet e EJL6 (Figura 8), që përgjigjet për 58.2 përqind të totalit të eksporteve (shifër e vitit 2010), ku përqindja e luanit i takon vendeve si Italia dhe Gjermania. Tregtia me vendet e rajonit përgjigjet për afërsisht 22 përqind të eksporteve të ekonomive të vendeve të EJL6 dhe është në veçanti e rëndësishme për vende si Serbia dhe Mali i Zi.


Figura 8: Eksportet (% e PBB)



Burimi: bankat qendrore te EJL6 dhe UNCTAD.

Luhatjet e performancës së eksporteve gjatë krizës së vitit 2009 ishin edhe më të theksuara në vendet e EJL6 sesa në ato EU10. Pas një performace të fortë të rritjes të periudhës përpara krizës në vitet 2007 e 2008, eksportet ranë me 14.7 përqind në vitin 2009, në krahasim me 9 përqind për vendet e EU10-ës. Gjatë vitit 2010 pati një rikuperim të shëndoshë të eksporteve: eksportet e vendeve të EJL6 u rritën me 20 përqind, në krahasim me 12.3 përqind për vendet e EU10-ës (Figura 9). Rritja e shpejtë u nxit nga rritja e kërkesës dhe çmime më të larta të mallrave. Në tremujorin e tretë të vitit 2010, eksportet kishin rikuperuar nivelet e tyre të përpara krizës. Rritja e eksporteve shënoi kulmin e vet në tremujorin e parë të vitit 2011 me 29.7 përqind vit-mbi-vit (v-m-v) dhe qysh atëherë ka ardhur duke u ngadalësuar.


Figura 9: eksportet dhe rritja ekonomike (%)



Burimi: bankat qendrore te EJL6 dhe Eurostat.

Shenim: Rritja e eksporteve jepet me kolona, ndersa rritja reale e PBB me rreshta.

Figura 10: rritja e importeve (%)




Burimi: bankat qendrore te EJL6 dhe Eurostat.

Dinamikat e importit në vendet e EJL6-ës janë të ngjashme me ato të eksporteve, por me një rënie më të thellë gjatë vitit 2009 dhe më një rikuperim më të zbehtë. Importet ranë me 22 përqind në krahasim me 16 përqind që ishte shifra për vendet e EU10 dhe u rikuperuan me vetëm 9 përqind në vitin 2010 në krahasim me 12 përqind që ishte shifra për vendet e EU10-ës (Figura 11). Rritja e importeve gjatë vitit 2010 reflekton çmimet më të larta të naftës dhe ushqimeve. Por kjo rritje u pasua me një zhvillim ekonomik relativisht të ngadaltë, në veçanti në Serbi ku u shënuan tetë tremujore të njëpasnjëshme të rritjes negative të importeve vit pas viti.


Deficitet e llogarisë rrjedhëse (CAD), të cilat kishin arritur nivele që nuk mbanin më në disa prej ekonomive të vendeve të EJL6-ës në vitin 2008, qysh nga ajo periudhë janë përmirësuar ndjeshëm, dhe kjo kryesisht si rezultat i një rimëkëmbje më të ngadalshëm të importeve sesa të eksporteve, ndonëse me ndryshime nga vendi në vend. Nivelet e larta të importeve të para krizës në rajonin e EJL6-ës u nxitën nga një kërkesë e rritur vendase e krijuar nga ekspansioni ekonomik i vitit 2008. Kjo si edhe një ngadalësim i eksporteve në Bosnje- Hercegovinë, Shqipëri dhe Serbi, bashkë me një rënie të eksporteve në Kosovë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi në tremujorin e fundit të vitit 2008 çuan në një CAD prej 19.2 përqind të PBB-së për vendet e EJL6 në vitin 2008. Por duke qenë se importet ranë më shumë se eksportet në të gjitha vendet gjatë vitit 2009, dhe rritja e eksporteve pësoi një rikuperim të shpejtë vitin pasues, si bilanci tregtar ashtu edhe CAD u përmirësuan me afërsisht 10 pikë përqindjeje të PBB-së në vitin 2010 krahasuar me vitin 2008.

Figura 11: rritja e eksporteve dhe importeve, (% y-o-y)




Burimi: bankat qendrore te EJL6

Figura 12: CAD dhe bilanci tregtar ne vendet e EJL6 (% e PBB)



Burimi: bankat qendrore te EJL6, llogaritje të stafit të BB

Figura 13: Deficiti i llogarisë korente, (% e PBB)




Burimi: bankat qendrore dhe IMF WEO, llogaritje të stafit të BB

Pavarësisht nga përmirësimet e kohëve të fundit në vendet e EJM6-ës, deficitet e llogarive rrjedhëse ende mbeten të larta, në veçanti në Malin e Zi dhe në Kosovë. Deficiti i llogarive rrjedhëse në vendet e EJM6-ës u përmirësua duke arritur në një shifror në vitin 2010, por ende mbetet i lartë në vendet e EU10-ës dhe EU15-ës (Figurat 13). Në Malin e Zi, deficiti i llogarisë korente ishte shumë e lartë e nxitur nga investimet e huaja direkte dhe nga kërkesë e fortë vendase gjatë viteve 2007-2008 (Figura 14). Qysh nga ajo periudhë deficiti i llogarisë korente ka pësuar rënie, por ka mbetur mbi 20 të PBB-së, sikundërse edhe deficiti i lartë dhe në rritje i llogarisë korente të Kosovës që është krijuar kryesisht nga ndërtimi i autostradës.

Ndërsa remitancat (të ardhurat nga emigracioni) nuk kanë lëvizur për të gjithë rajonin e EJM6-ës, këtu fshihen diferenca sinjifikative nga vendi në vend. Ka një diasporë të madhe të krahut të punës të vendeve të EJM6-ës të punësuar në vendet me të ardhura të larta të BE si dhe në ShBA, Kanada dhe Australi. Gjatë krizave të fundit, disa nga këto vende pritëse ndërmorën masa për të ruajtur punësimin dhe në këtë kuadër remitancat u prekën relativisht pak. Megjithatë, diaspora shqiptare është e përqendruar në Greqi dhe në Itali dhe ky është praktikisht edhe krahu i punës që është prekur më negativisht (Figura 15).


Gjatë periudhës 2008-2010 pati një ngritje të ndjeshme të borxhit të jashtëm bruto dhe të borxhit qeveritar përkundërt raporteve të PBB (Figura 16). Borxhi i jashtëm u rrit me 13 pikë përqindjeje të PBB-së (për të arritur kulmin me 64.3 përqind të PBB-së në vitin 2010). Afërsisht 2/3 e këtij borxhi i atribuohen huamarrjes qeveritare (9 pikë përqindjeje të PBB-së) me qëllim financimin e deficiteve fiskale për të zbutur efektet e krizës. Nga qershori i vitit 2009 deri në shtator të vitit 2011, katër vende kanë

Figura 14: Deficiti i llogarisë korente sipas vendeve (% e PBB)



Burimi: bankat qendrore te EJM6


Figura 15: Remitancat dhe kompensimi i punëtorëve (% e PBB)



Burimi: Bankat qendrore te EJM6.

emetuar Eurobonde (Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë në vitin 2009, Shqipëria në vitin 2010, Mali i Zi në vitin 2010 dhe 2011 si edhe Serbia në vitin 2011) (Figura 17). Përveç kësaj disa prej vendeve të EJL6 përdoren alokimet e FMN-së kuotën e tyre dhe të ardhurat e kredisë të cilat rriten borxhit.


Figura 16: borxhi i jashtëm (% e PBB)



Burimi: Bankat qendrore dhe MF e EJL6.

Shenim: Përkufizimi i borxhit të jashtëm nuk është i njëjtë për të gjitha vendet e EJL6-ës.


Figura 17: Emetimi i eurobondeve (mln dollarë)



Burimi: Ministrinë e Financave (MF) të vendeve të EJL6-ës.

Grupi i vendeve të EJL6-ës është heterogjen për sa i përket nivelit të borxhit të jashtëm, ndonëse tendenca është në rritje për të gjitha (Figura 18). Mali i Zi dhe Serbia janë dy vende mbi mesataren rajonale, si edhe kanë rritjen më të lartë të borxhit, ndërsa Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Bosnje- Hercegovina janë pak nën mesataren e vendeve të EJL6-ës.

Figura 18: Totali i borxhit të jashtëm publik dhe privat (% e PBB)



Burimi: Bankat qendrore dhe MF e vendeve të EJL6, FMN, BB.


4. POLITIKA MONETARE DHE SEKTORI FINANCIAR

Në të gjitha vendet e EJL6, me përjashtim të Malit të Zi, depozitat bankare janë rikuperuar gjatë mesit të vitit 2011, pas valës së parë të krizës globale ekonomike, nga fundi i vitit 2008 dhe fillimi i vitit 2009.

Asokohe, pjesa më e madhe e vendeve të EJL6-ës përjetuar një tërheqje depozitash pak ose disi shqetësues. Mali i Zi përjetoi rënien më të madhe, ku stoku i totalit të depozitave ra me afërsisht 25 përqind nga shtatori i vitit 2008 deri në muajin mars të vitit 2009. Gjatë së njëjtës periudhë, Serbia përjetoi një rënie të depozitave (të shprehura në euro) afërsisht me 20 përqind, Shqipëria një rënie me afërsisht 15 përqind, Bosnje- Hercegovina një rënie afërsisht prej 10 përqind, dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë një rënie me afërsisht 4 përqind.


Përjashtim bënte Kosova, ku pati një ngadalësim të rritjes së depozitave, por nuk u kthye në negative. Qysh nga mesi i vitit 2009, totali i depozitave i shprehur në euro ka nisur të rikuperohet dhe tashmë i ka kaluar nivelet e para krizës në të gjithë rajonin e EJL6-ës, si edhe në pjesën më të madhe të vendeve të marra individualisht: depozitat në vendet si Shqipëria, Kosova, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Serbia janë mbi nivelet e para krizës, ndërsa në Bosnje-Hercegovinë ato janë shumë afër niveleve të para krizës. I vetmi përjashtim është Mali i Zi, ku niveli i depozitave mbetet shumë nën atë të kulmit të para krizës (në nivelin 20 përqind qysh nga muaji gusht). Deri tani nuk ka asnjë shenjë që një valë e dytë e krizës po shkakton një tjetër raund tërheqje depozitash, por kjo mundësi nuk përjashtohet gjithsesi (Figura 19).

Figura 20a: rritja reale v-m-v e kreditimit për sektorin privat




Burimi: Bankat qendrore të EJL6.

Figura 19: Totali i depozitave (vlera në euro, shtatori 2008=100)



Burimi: Bankat qendrore të EJL6.

Figura 20b: rritja nominale v-m-v e kreditimit për sektorin privat




Burimi: Bankat qendrore të EJL6.

Gjithashtu ka patur një rënie të ndjeshme të aktivitetit të kreditit gjatë pjesës më të madhe të vitit 2009; gjatë viteve 2010 dhe 2011, aktiviteti i kreditit e morri veten, por me nivele shumë më poshtë atyre të niveleve të para krizës. Në periudhën e lulëzimit të kredive përpara krizës së vitit 2008, rajoni i EJL6-ës përjetoi një rritje reale të kreditimit ndaj sektorit privat në shifra të larta dyshifrore (Figura 20a). Me valën e parë të krizës nga fundi i vitit 2008, pati një ngadalësim të ndjeshëm të ekspansionit të kredive. Qysh nga fillimi i vitit 2010, kreditë për sektorin privat u stabilizuan dhe në përgjithësi edhe aktualisht ka një ekspansion, por në nivele shumë më modeste (dhe të qëndrueshme) sesa ato të përpara krizës. Kështu, p.sh. rritja nominale e kredisë vit pas vitit në sektorin privat (e shprehur në euro) në vende të ndryshme të EJL6 varion nga 30 përqind në mbi 50 përqind në tremujorin e tretë të vitit 2008; qysh nga tremujori i dytë i vitit 2011, ajo është midis 5 përqind dhe 15 përqind (dhe në Malin e Zi është negative) (Figura 20b).

Politikat monetare janë të kufizuara nga kufizime specifike në vende të ndryshme; një qëndrim plotë akomodues nuk ishte i mundur pas pasojave të krizës. Kështu, p.sh. Banka qendrore e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë u përball me probleme në lidhje me fiksimin e kursit të këmbimit, duke rritur në fakt përqindjen e referencës në muajt që pasuan krizën. Banka qendrore e Serbisë u përball me inflacion të lartë dhe edhe ajo bëri rritje të përqindjes së referencës nga fundi i vitit 2008, dhe më pas në një cikël tjetër nga mesi i vitit 2010 deri në mesin e vitit 2011 (Figura 21). Për më tepër, gjatë periudhës kur shumica e bankave qendrore po përballeshin me një tërheqje depozitash, atyre iu desh të shmangin një ulje të konsiderueshme të interesit bazë. Një pengesë tjetër vinte nga fakti që Kosova dhe Mali i Zi kishin futur në mënyrë të njëanshme monedhën evropiane, Bosnje- Hercegovina ka një bord monedhe të bazuar në euro, ndërsa Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka një kurs të menaxhuar këmbimi duke përdorur Euron si referencë; vetëm Shqipëria dhe Serbia kanë regjime fleksibël të kursesh këmbimi. Në rastin e vendeve me kurs fleksibël këmbimi stabiliteti financiar ishte gjithashtu një shqetësim për shkak të efektit të një zhvlerësimi të menjëhershëm të detyrimeve nominale valutore të bankave.


Inflacioni arriti kulmin e tij gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, pas një rritjeje qysh nga fundi i vitit

Figura 22: Inflacioni në EJL6, (%)



Burimi: EJL6 Zyrat kombëtare të statistikave, FAO, Bloomberg.

Figura 21: Normat bazë të interesit (%)



Burimi: Bankat qendrore te EJL6.


2009 dhe tani po vjen gradualisht duke u ulur. Kolapsi i kërkesës vendase çoi në një kolaps të inflacionit me fillimin e krizës të periudhës 2008/2009. Megjithatë, qysh nga tremujori i fundit të vitit 2009, inflacioni u rrit në kurriz të rritjes së cimeve globale të ushqimit dhe energjisë (Figura 22). Në veçanti, vendet e EJL6-ës e sigurojnë një përqindje të madhe të CPI-së së tyre nga çmimet e ushqimeve dhe energjisë. Inflacioni arriti kulmin në tremujorin e parë të vitit 2011 me zbutjen e këtyre presioneve të jashtme të çmimeve. Serbia në veçanti përjetoi një rritje të fortë të inflacionit, ku CPI-ja arriti kulmin e vet në muajin prill me 14.7 përqind vit-mbi-vit; qysh nga ajo periudhë ka zbritur në 9.3 përqind në muajin shtator.

Kutia 1: Diferencat e çmimeve në EJL6

Krahasimi i çmimeve në vende të ndryshme mund të shërbejë për të hedhur dritë mbi çështje të rëndësishme që lidhen me ekonominë siç janë tregtia rajonale dhe integrimi evropian, konvergjenca e të ardhurave për frymë dhe politikat mbi kursin e shkëmbimit. Teoritë ekonomike sugjerojnë se rritja e integritit rajonal dhe atij në BE – që vjen nga heqja e pengesave tarifore dhe jo tarifore ndaj tregtisë⁶ - duhet të sjellë konvergjencë të çmimeve brenda rajonit të Evropës Juglindore (EJL), me ato të BE-së. Fakte të ndryshme nga BE-ja e mbështesin fuqimisht teorinë e konvergjencës së çmimeve.

Nivelet e çmimeve në vendet e EJL6-ës ndryshojnë si brenda për brenda rajonit, ashtu edhe në lidhje me tregun evropian ku rajoni synon të integrohet më thellësisht. Brenda për brenda rajonit, çmimet janë më të ulëta në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (44 përqind e mesatares së EU-27-ës) dhe më të larta në Malin e Zi (59 përqind e mesatares së EU-27-ës). Çmimet në rajon në tërësi janë shumë më të ulëta nga mesatarja e BE-së (Figura 23). Është me interes të theksojmë se konvergjenca e çmimeve në disa vende të EJL-së është më e lartë sesa në vendet më të reja anëtare të BE-së, si Bullgaria dhe Rumania, pavarësisht nga fakti që këto dy vende kanë të ardhura më të larta për frymë dhe janë pjesë e Tregut të Vetëm. Kjo mund të shpjegohet pjesërisht me pagat e ulëta mesatare në Rumani dhe në veçanti në Bullgari.

Figura 23: Niveli i çmimeve dhe PBB për frymë në PPP për rajonin me të gjerë të EJL




Burimi: Eurostat.

Gjithashtu, çmimi i një malli homogjen të prodhuar në vend (me përjashtim të Kosovës dhe Malit të Zi) si Coca-Cola mund të përdoret për të vlerësuar diferencat në çmime, si edhe përshtatshmërinë e përqindjeve të kursit të këmbimit në rajon. Gjatë 25 viteve të fundit, revista Economist ka publikuar indeksin Big Mac për këtë qëllim. Ndonëse një vlerësim i tillë nuk duhet përdorur si bazë për politikë-bërje, diferencat në çmime mund të përdoren si udhëzime për të konstatuar nëse ka nevojë për analiza të mëtejshme. Coca-Cola ka çmimin më të lirë në Shqipëri dhe më të shtrenjtin në Bosnje-Hercegovinë: çmimi mesatar i Coca-Cola-s në Sarajevë është 34 përqind më i lartë sesa në Tiranë. Ka një dallim të madh në strategjitë e çmimeve të Coca-Cola-s midis dyqaneve të vogla dhe atyre të mëdha. Në rast se do të bëhej një krahasim i çmimeve të Coca-Cola-s që tregtohet në dyqane të vogla, Serbia ka çmimin më të lartë.

⁶ Me heqjen e barrierave ndaj tregtisë, “efekti i ashtu-quajtur Balassa-Samuelson” kujdeset për konvergjencën e çmimeve, edhe në rastin e mallrave dhe shërbimeve jo të tregtueshme. Produktiviteti më i lartë në sektorët e tregtueshëm në vendet e pasura çon në paga më të larta për ato sektorë, por duke qenë se firmat konkurrojnë për krahe pune, kjo gjithashtu ngre pagat në sektorët jo të tregtueshëm. Rrjedhimisht, çmimet mesatare të mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme dhe jo të tregtueshme janë më të larta në vendet e pasura.

Me përshkallëzimin e krizës në vitin 2009 u shënua edhe një rritje e shpejtë e huave me probleme (NPLs) në të gjitha vendet e EJL6-ës; qysh nga ajo periudhë NPL-të janë stabilizuar në disa, por jo në të gjitha vendet dhe ende mbeten shumë më lartë nivelit të tyre të para krizës. Përpara krizës së vitit 2008, nivelet e NPL-ve në të gjitha vendete e EJL6-ës ishin në nivele relativisht të ulëta (në përgjithësi nën 5 përqind). Por me përshkallëzimin e krizës u shënua një rritje e ndjeshme e huave të këqija (Figura 24). Gjatë vitit 2010, pati një stabilizim të NPL-ve në Bosnje- Hercegovinë, Kosovë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbi (ndonëse në nivel të ngritur), por ato vazhdojnë të rriten në Mal të Zi dhe Shqipëri.


Figura 24: Huatë me probleme (% e totalit të huave)



Burimi: Bankat qendrore të EJM6.


Nga ana tjetër, me disa përjashtime, bankat në rajon mbeten likuide dhe raportojnë rezerva solide kapitali (kështu p.sh. raportet e mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011 ishin afërsisht 16 përqind në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe 20 përqind në Serbi) që garantojnë siguri të mjaftueshme në lidhje me aftësinë për të absorbuar tronditje të mëtejshme. Për më tepër, shumica e bankave gradualisht iu kthyen fitimit në vitin 2010 dhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 (Figura 25). Provigjonet për humbjet e huave janë rritur ndjeshëm në disa vende dhe në disa të tjera ato ishin në nivele relativisht të larta në fazat fillestare të krizës (Figura 26).

Figura 25: EJM6 Kthimet mbi aktivet (majtas) dhe mbi kapitalin (djathtas) të sistemeve bankare, në %




Burimi: Bankat qendrore.

Figura 26: provigionet për humbjet e kredive, si përqindje e totalit të huave bruto



Burimi: Bankat qendrore të EJL6.

Figura 27: EMBI spreads, vende të përzgjedhura, vende të përzgjedhura, (bps)




Burimi: Bloomberg.

Shënim: Indeksi evropian përfshin: Bjellorusinë, Bullgarinë, Kroacinë, Hungarinë, Lituani, Poloninë, Rusinë, Serbinë, Turqinë dhe Ukrainën.

Në rajon po rikthehet risku i kredisë dhe financimit, shkaktuar kryesisht nga zhvillimet negative brenda BE-së, një barrë kredish me probleme në shumë vende të EJL6, dhe ngadalësimi i rritjes ekonomike. Spreadi EMBI për Serbinë (i vetmi vend nga rajoni i EJL6-ës ku disponohen të dhëna mbi spreadin EMBI) është rritur gjatë dy muajve të fundit, ndonëse kohët e fundit ka patur një farë rënijeje. Megjithatë, rritja e primit të riskut për Serbinë, sipas matjeve nga spreadet EMBI është plotësisht e lidhur me rritjen e përgjithshme të perceptimit të riskut; spreadet relative përkundrejt vendeve të tjera në Evropë ka mbetur i pandryshuar (Figura 27). Kjo sugjeron që përkeqësimi është i gjithi i shkaktuar nga faktorë të jashtëm.

Aktualisht, sistemet bankare në përgjithësi në vendet e EJL6-ës duket të jenë fleksibël, me nivele të larta likuiditeti dhe rezerva të rëndësishme kapitali, por kjo mund të ndryshojë papritmas, sidomos për disa banka specifike. Njësoj si vendet e EU10-ës, pothuajse të gjitha bankat e huaja në EJL6 janë nga vende të BE-së (Figura 28). Megjithatë, rajoni i EJL6-ës karakterizohet nga një përqindje krahasimisht e lartë e bankave me pronësi greke dhe italiane (Tabela 3). Në përputhje me kërkesën e përgjithshme në BE për rritjen e kapitalit të bankave kryesore, rritja e trysnive mbi fondet e bankave përkatëse mëmë mund të ushtrojë tryzni mbi bankat e huaja për sigurimin e likuiditetit apo dividendëve për bankat mëmë. Kjo ka mundësinë të shkaktojë një tjetër ngërç kredie në rajon. Fakti që shumica e këtyre bankave operojnë si banka dhe jo si degë e rrjedhimisht janë objekt monitorimi dhe rregullimi i mbikëqyrjes lokale të vendeve përkatëse të EJL6-ës garanton siguri të mëtijshme që një mbyllje e menjëhershme e pozicioneve të tyre nuk është e mundur.

Figura 28: Ndarja gjeografike e përqindjeve të bankave të huaja në sektorin bankar të vendeve të EJL6-ës




Burimi: BIS (statistika të konsoliduar bankare).

Tabela 2: Pretendimet⁷ e bankave të EJL6 ndaj vendeve kyçe janë të mëdha si % ndaj PBB **Figura 29: Financimet e huaja të bankave, 2010**

Vendi	Greqi	Itali	Portugali	Spanjë
EJL6	13.2	15.2	-	0.0
Shqipëri	14.0	9.3	-	-
Bosnia dhe Herzegovina	-	21.2	-	0.0
Maqedonia	20.2	0.3	-	0.0
Mali i Zi	0.6	-	-	-
Serbia	18.3	19.3	-	0.0
BE10 + Kroaci	3.5	13.0	1.3	0.7

Burimi: BIS (statistika të konsoliduara bankare), Banka Botërore WDI.




Burimi: FMN, WDI.

†qe nga viti 2008, *qe nga viti 2009.

EU10: Bullgaria, Republika Ceke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia; EJL6: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Maqedonia, Serbia

Niveli i vartësisë së përgjithshme të bankave të EJL6-ës nga fondet e jashtme është më i ulët sesa ai i vendeve të EU10-ës (Figura 29). Në rajonin e EJL6-ës, bankat e huaja janë gjithmonë e më shumë ta varura për fonde nga depozitat vendase. Siç është përmendur edhe më lart aktualisht nuk ka ndonjë të dhënë për tërheqje depozitash të ngjashëm me atë të krizës të vitit 2008, ndonëse situata ka nevojë për monitorim të kujdesshëm. Spredet CDS për bankat më të mëdha që operojnë në rajon janë rritur qysh nga fillimi i vitit (me një reduktim/zbritje që nga fundi i muajit shtator), që mund të çojë në përqindje më të larta interesi (Figura 30).

Figura 30: Spredet CDS për disa banka të përzgjedhura



Burimi: Reuters, Bloomberg, përlloraritjet e stafit të Bankës Botërore.

⁷ Pretendimet përfaqësojnë kreditë dhe aktivet e tjera të brendshëm të këtyre bankave, duke përfshirë ato të financuara nga depozitat vendase

Çdo përkeqësim i mundshëm i mëtejshëm i bankave kryesore mëmë evropiane do të ketë një ndikim negativ në sektorin real të EJL6-ës. Huadhënia direkte ndërkufitare përbën një burim të rëndësishëm për sektorin real të EJL6-ës dhe arrin afërsisht në 18 përqind të PBB-së (Tabela 4). Në rastet se bankat në Evropë përjetojnë tensione të mëtejshme të forta ka gjasa që firmat individuale të përballen me vështirësi në rifinancimin e këtyre huave. Njëkohësisht, prurjet e IHD-ve dhe ato të portofolit përbëjnë një burim më të stabilizuar financimi që ka më pak gjasa të çojë në paqëndrueshmëri. Thënë kjo, investimet e huaja direkte në vendet e EJL6-ës janë ngadalësuar qysh nga gjysma e dytë e vitit 2008 dhe tani janë në afërsisht 60 përqind të niveleve të para krizës (Figura 31).

Tabela 3: Burimet e financimit të sektorit real (% e PBB-së, 2010)


Vendi	Kredita e brendshme bankare				Huamarrje e huaj				IHD dhe investimi i portofolit të huaj në kapital			
	Stok		Rritja		Stok		Rritja		Stok		Rritja	
	2010	2008	2009	2010	2010	2008	2009	2010	2010	2008	2009	2010
Evropa qendrore dhe Azia	48.9	0.2	0.0	0.1	18.5	3.0	0.2	0.4	49.2	5.7	3.1	1.6
EJL6	49.1	0.2	0.0	0.1	18.2	9.1	1.4	0.8	34.7	7.0	5.9	4.7
Shqipëria	37.8	0.4	0.1	0.0	6.3†	1.2	1.0	0.6	22.1†	7.6	8.2	9.5
Bosnje Hercegovina	58.3	0.1	-0.1	0.0	0.0*	4.1	3.3	3.5	11.0*	5.0	1.4	0.4
Kosova	35.1	0.3	0.1	0.1	n.a.	2.9	3.1	3.3	n.a.	9.5	7.5	7.4
Maqedonia	44.5	0.3	0.0	0.0	20.8*	3.4	2.8	1.3	49.5*	5.7	2.0	3.2
Mali i Zi	69.9	0.2	-0.1	-0.1	n.a.	10.9	-1.5	2.8	n.a.	21.2	36.9	18.5
Serbia	49.5	0.2	0.1	0.2	33.4	14.8	0.5	-1.0	53.7	6.2	4.7	3.6
EU10 + 1	59.5	0.2	0.0	0.0	18.8	2.2	0.6	0.2	66.5	9.0	2.6	-0.7

Burimi: FMN Statistikat Financiare Ndërkombëtare dhe Statistikat e Bilancit të Pagesave, Banka Botërore WDI.

Rritja e financimeve të huaja matet si hyrjet neto si përqindje e PBB-së. Rritja e kreditimit të bankave vendase matet si rritje reale e përqindjes së PBB.

†që nga viti 2008, *që nga viti 2009.

Figura 31: Prurjet neto të IHD në rajon, milionë euro



Burimi: Bankat qendrore te EHL6.

5. POLITIKA FISKALE DHE BORXHI PUBLIK

Situata fiskale mbetet e brishtë dhe autoritet e EJL6-ës duhet të rindërtojnë rezervat fiskale dhe të jenë të gatshëm dhe të përgatitur për një konsolidim të mëtejshëm të shpenzimeve në rast se parashikimet për të ardhurat nuk arrijnë të përmbushen si rrjedhojë e përkeqësimit të kushteve globale. Gjatë këtyre viteve të fundit, vendet e EJL6-ës i ezauruan rezervat modeste të krijuara gjatë periudhës së para krizës ku kishte rritje të lartë ekonomike dhe të ardhura të begata. Me përjashtim, të Kosovës, asnjë vend tjetër nuk ka depozita të konsiderueshme për t'i futur në punë. Gjithashtu, tregjet vendase të kapitalit janë të cekta, ndërsa bankat aktualisht duket të kenë likuiditet të fortë, por kjo mund të ndryshojë me shpejtësi në rast të një ngadalësimi më të thellë të veprimtarisë ekonomike. Për më tepër, aksesimi ndaj tregjeve të financave të huaja do të mbetet i vështirë për vendet e EJL6-ës në të ardhmen.

Vendet e EJL6-ës kanë zbatuar politika fiskale komplet të ndryshme përpara krizës financiare globale të periudhës 2008-09. Mesatarja e deficitit fiskal për rajonin gjatë kësaj periudhe ishte relativisht e vogël. Megjithatë kjo fsheh diferenca të ndjeshme midis vendeve të ndryshme. Shqipëria ka patur vazhdimisht deficite afër ose mbi 3 përqind të PBB-së, ndërsa Bosnje- Hercegovina ishin me suficit. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë në përgjithësi është karakterizuar nga një buxhet i balancuar; Kosova dhe Mali i Zi i zëvendësuan deficitet në fazat fillestare të periudhës në fjalë me suficite, ndërsa Serbia kaloi nga një buxhet i balancuar në deficit.

Tabela 4: Deficitet fiskale (% e PBB)

	2005	2006	2007	2008	2009	2010
ALB	-2.8	-3.2	-3.7	-5.5	-7.1	-3.0
BIH	0.1	2.8	0.6	-3.5	-5.6	-4.2
KOS	-3.1	2.5	7.3	-0.2	-0.7	-2.7
MKD	0.2	-0.5	0.6	-0.9	-2.7	-2.5
MZI	-1.8	2.9	6.7	-0.4	-5.7	-4.9
SRB	0.8	-1.6	-1.9	-2.7	-4.5	-4.6
Mesatarja	-0.3	-0.5	-0.5	-2.7	-4.6	-3.8

Burimi: Përlllogaritjet e stafit bazuar në të dhënat e MF. FMN për BiH

Deficitet fiskale gjatë periudhës 2005-07 do të kishin qenë shumë të mëdha (dhe suficitet më të vogla) po të mos ishte rritja e fortë e të ardhurave si rezultat i rritjes së kërkesës vendase. Të ardhurat (si përqindje e PBB-së) u rritën në të gjitha vendet, me përjashtim të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbisë. Njëkohësisht, shpenzimet (si përqindje e PBB) u rritën në pjesën më të madhe të vendeve, me rritjet më të larta të shënuara nga Serbia dhe Mali i Zi. Në kombinim me një rritje të fortë të PBB-së, deficitet relativisht të ulëta rezultuan në një reduktim të ndjeshëm të raportit të borxhit qeveritar përkundrejt PBB-së (kjo pavarësisht njohjes së detyrimeve nga disa prej qeverive të vendeve të Evropës Juglindore, si p.sh. kompensimi në Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe pretendimet për dëme lufte dhe depozitat në valutë të ngrira në Bosnje-Hercegovinë). Nga fundi i vitit 2008, borxhi qeveritar në vendet e EJL6-ës ra tek 33.9 përqind e PBB-së⁸; një përqindje kjo e ngjashme me mesataren e vendeve të EU10-ës (36 përqind e PBB-së) dhe shumë më poshtë kritereve të Maastrichtit për 60 përqind të PBB-së. Shqipëria bënte përjashtim me një borxh qeveritar prej 55 përqind të PBB-së, gjë që reflekton deficitet e

⁸ Përveç zhvillimeve në lidhje me deficitin, dinamikat e borxhit në disa prej vendeve të EJL6-ës u influencuan ndjeshëm nga njohja e detyrimeve në lidhje me likuidimin e detyrimeve të trashëguara (depozita të ngrira të monedhës së huaj në kohën e ndarjes së ish-Jugosllavisë, dëme lufte, pretendime për detyrime kompensimi).

saj të vazhdueshme. Nga ana tjetër, nga fundi i vitit 2008, Kosova nuk raportonte asnjë borxh qeveritar që reflekton politikën konservatore fiskale, por edhe arsyet historike⁹.

Performanca fiskale është përkeqësuar në të gjitha vendet qysh nga viti 2008, pavarësisht nga rezultatet relativisht homogjene të rezultateve të rritjes ekonomike. Mesatarja e rritjes ekonomike në vendet e EJL6-ës u kthye në negative në vitin 2009, ndërsa pati një kolaps të eksporteve dhe prurjeve të kapitalit, ndonëse me diferenca të ndjeshme nga vendi në vend. Situata fiskale u përkeqësua në të gjitha vendet, duke shpalosur brishtësinë e krijuar nga vartësia ekseseive ndaj lulëzimit të kërkesës vendase në periudhën përpara krizës. Mesatarja e deficitit fiskal u rrit në 2.7 përqind të PBB-së në vitin 2008 dhe më pas në 4.6 përqind të PBB-së në vitin 2009. Të ardhurat si përqindje ndaj PBB ranë në të gjitha vendet (me përjashtim të Kosovës dhe të Shqipërisë ku ato vazhduan të rriten) dhe vendi më i prekur ishte Mali i Zi. Nga ana tjetër, shpenzimet si përqindje ndaj PBB u rritën në të gjitha vendet (me përjashtim të Serbisë) me rritjet më të larta të regjistruara në Kosovë, Bosnje- Hercegovinë dhe në Shqipëri.

Gjatë vitit 2010 pati axhustime të kufizuara fiskale, ndërsa ekonomitë e vendeve të EJL6-ës përpiqeshin të përshpejtonin rritjen e tyre ekonomike. Axhustimi më i madh fiskal i takon Shqipërisë, ku deficit fiskal u reduktua nga mbi 7 përqind të PBB-së në vitin 2009 në 3 përqind të PBB-së në vitin 2010, e pasuar nga Mali i Zi që ndërmori një axhustim prej 1.5 pp të PBB-së dhe nga Bosnje-Hercegovina që e reduktoi deficitin me 1.4 pikë përqindjeje të PBB-së. Mesatarja e deficitit fiskal në ekonomitë e vendeve të EJL6-ës ra në 3.8 përqind të PBB-së. Nga ana tjetër pati rritje të deficitit në Kosovë dhe në Serbi. Rrjedhimisht, borxhi qeveritar i vendeve të EJL6-ës u rrit edhe më tej duke arritur 38.4 përqind të PBB-së në vitin 2010. Përkeqësimi i llogarive fiskale dhe borxhit qeveritar megjithatë nuk ishte aq i madh sa në vendet e EU10-së, ku borxhi qeveritar u rrit në 47.1 përqind të PBB-së.

Me përjashtim të Shqipërisë, nivelet e borxhit qeveritar mbeten poshtë 50% të PBB-së, por situata është tejet e brishtë për shkak të kushteve të jashtme. Struktura e borxhit është e favorshme, me një ekspozim relativisht të vogël ndaj huamarrjes tregtare dhe rrjedhimisht me kosto relativisht të ulëta të shërbimit të borxhit.¹⁰ Megjithatë ndonëse borxhi publik si përqindje e PBB-së është më i ulët sesa në vendet e EU10-ës, borxhi publik si përqindje e të ardhurave vjetore qeveritare, tek afërsisht 111.4 përqind e PBB-së, është më afër mesatares së EU10-ës. Sërish mbetet për t'u theksuar se ekonomia shqiptare është ajo më e brishta, ku borxhi përbën më shumë se dyfishin e të ardhurave vjetore.

Tabela 5: Tregues të përzgjedhur te borxhit qeveritar*

	ALB	BIH	KOS	MKE	MZI	SRB	EJL6	EU10
Borxhi, si % e PBB	58.2	36.9	6.9	24.6	51.3	42.9	38.4	47.1
Borxhi, si % e të ardhurave	219.7	82.0	25.1	79.9	121.9	104.7	111.4	124.8
Shpenzimet e interesit, si % e PBB	3.4	0.6		0.7	1.0	1.2	1.3	

Burimi: Llogaritjet e stafit të BB bazuar në të dhënat e MF.

Pjesa dërrmuese e vendeve të EJL6-ës ka ndërmarrë rregullore që kufizojnë nivelin e borxhit publik. Megjithatë, angazhimi i autoriteteve për zbatimin e këtyre objektivave mbetet për t'u provuar.

⁹ Kosova ende ka për të marrë përsipër pjesën e vet të borxhit nga ish Jugosllavia. Përcaktimi përfundimtar i pjesës së Kosovës në këtë borxh është ende për t'u vendosur dhe mund të shtojë afërsisht 10 përqind të stokut të borxhit ndaj PBB-së.

¹⁰ Mesatarja e shpenzimeve për interesin është afërsisht 1 përqind e PBB-në vendet e EJL6-ës, ku bën përjashtim Shqipëria ku shpenzimet për interesin në vitin 2010 përfaqësonin 3.4 përqind të PBB-së.

Shqipëria, Kosova dhe Serbia kanë vënë tavane për borxhin qeveritar përmes legjislacionit, ndërsa në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Malin e Zi kjo është bërë përmes dokumenteve të nivelit strategjik.

Buxhetet e vitit 2011 të vendeve të EJL6-ës nuk kishin parashikuar masa për një axhustim të qenësishëm fiskal. Shqipëria dhe Kosova e rritën pak deficitin e parashikuar, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Serbia po e ruajnë deficitin në nivelet e vitit 2010, kurse vetëm Bosnje-Hercegovina dhe Mali i Zi kanë planifikuar reduktim të deficitit fiskal. Sipas të dhënave më të fundit të disponueshme, vendet duket se janë në rrugën e duhur për të përmbushur objektivat e tyre për deficitet, ndonëse do të kërkohej për këtë qëllim një kujdes i vazhdueshëm. Kosova shënoi një suficit të vogël gjatë gjysmës së parë të vitit dhe një deficit të vogël gjatë tremujorit të tretë. Duke qenë se nuk parashikohen shpenzime të mëdha deri nga fundi i vitit, llogaritë fiskale të Kosovës ka gjasa të kenë një përmirësim të konsiderueshëm. Bosnje- Hercegovina ka një buxhet gjerësisht të balancuar (ndonëse këtu nënvleftësohet pozicioni real fiskal, duke qenë se nuk përfshihen shpenzimet për projektet e financuara nga jashtë që janë jashtë buxhetit). Deficiti fiskal i vendeve të tjera të EJL6-ës ka qenë afërsisht 2 përqind i PBB-së në gjysmën e parë të vitit 2011. Deficiti i Shqipërisë, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Malit të Zi ishte i moderuar gjatë tremujorit të tretë, duke i vënë këto vende në rrugë të drejtë për të përmbushur objektivat e tyre në lidhje me deficitin deri nga fundi i vitit. Megjithatë, deficitin në Serbi vazhdoi të rritej dhe kjo i detyroi autoritetet vendase të rrisnin deficitin e projektuar (nga -4 përqind e PBB-së në -4.5 përqind).

Tabela 6: Parashikimet fillestare dhe zhvillimet në gjysmën e parë të vitit 2011

	Të ardhurat	Shpenzimet	Bilanci fiskal	Bilanci në qershor 2011
	Projeksionet fillestare, % e PBB			Aktual
ALB	26.6	30.1	-3.5	-2.0
BIH	44.4	47.4	-3.4	NA
KOS	27.6	31.1	-3.5	1.1
MKD	31.4	33.9	-2.5	-1.7
MZI	40.5	42.8	-2.3	-1.5
SRB	39.1	43.7	-4.5	-3.0

Burimi: Për llogaritjet e stafit bazuar mbi të dhëna të MF.

Nevoja për të ushtruar një kujdes fiskal forcohet edhe më tej për shkak të kufizimeve të forta financiare me të cilat përballen vendet e EJL6-ës. Kohët e fundit Shqipëria ka kaluar në një borxh më afatshkurtër, me një rritje të lehtë koresponduese të interesave. Po kështu muajt e fundit Serbia është përballur me vështirësi për shkak të kërkesës së vakët për letra të borxhit qeveritar me maturitet më të gjatë se 2 muaj. Njëkohësisht, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë e përballur me zgjedhje të parakohshme në vend dhe më një situatë tepër të pastabilizuar nga jashtë vendosi të tërhiqte fonde nga Linja e Kredisë Paraprake (PCL) me FMN në pranverën e vitit 2011.

Megjithatë, nevojat imediate për financim duket se janë të garantuara. Serbia kohët e fundit arriti të emetonte një bono globale prej 1 miliardë dollarësh amerikanë, përveç huamarrjes së garantuar nga BERZH-i prej US\$400 milionë në fillim të vitit. Mali i Zi emetoi një Eurobond prej EUR180 milionë eurosh në prill të vitit 2011. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë përfitoi 220 milionë euro nga linja e kreditit PCL të FMN-së në mars të vitit 2011 dhe do të marrë një hua prej 130 milionë eurosh përmes një garancie nga BERZH-i nga fundi i vitit. Kosova mund të përdorë depozitat e forta të veta, ndërsa Shqipëria duhet të jetë në gjendje të financojë deficitin e mbetur përmes reduktimit të depozitës, si edhe përmes projekteve me financim të jashtëm. Burimet financiare të Bosnje-Hercegovinës parashikohet të mbeten modeste. Për sa i përket aksesit ndaj financimeve të huaja private, shumica e vendeve të EJL6-ës

karakterizohen nga klasifikime solide dhe nga një pozicion i stabilizuar në çdo vend, me përjashtim të Bosnje-Hercegovinës.

Tabela 7: EJL6 Vlerësimet e agjencive për borxhit sovran dhe parashikimi

	Standard and Poor's		Moody		Fitch	
	Vlerësimi/ parashikimi	data	Vlerësimi/ parashikimi	data	Vlerësimi /parashikimi	Data
Shqipëria	B+/Stable	19/04/2010	B1/Stable	29/06/2007		
BIH	B+/Negative	28/07/2011	B2/Negative	16/05/2011		
Maqedonia, FYR	BB/Stable	21/09/2009			BB+/Stable	27/10/2011
Mali i Zi	BB/Negative	31/03/2010	Ba3/Stable	30/03/2011		
Serbia	BB/Stable	16/03/2011			BB-/Stable	11/11/2010

Burimi: S&P, Moody dhe Fitch.

Shënim: Kosova nuk ka kërkuar ende një klasifikim të kredisë.

Siç pritej, performanca fiskale e kohëve të fundit po reflekton aktivitetin ekonomik në përgjithësi në vendet e EJL6-ës, por gjithashtu edhe inflacion më të lartë, si edhe faktorët jo-ekonomikë.

Kosova raporton për një rritje të fortë të të ardhurave tatimore (afërsisht 9.7 përqind në terma realë); megjithatë, kjo u zbut nga të ardhura më të ulëta jotatimore dhe kapitale (dividentë më të ulët). Totali i të ardhurave u rrit me 4.2 përqind në terma reale në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë gjatë gjysmës së parë të vitit, por kjo ishte kryesisht për shkak të pagesës së mëhershme të dividendit për Telecom-in. Me këtë përjashtim, të ardhurat në përgjithësi mbetën përgjithësisht të pandryshuara, ndërsa ndikimi i një kërkesë më të fortë vendase u zbut nga reduktimi i përkohshëm në akcizat e vendosura për të zbutur ndikimin e valës së çmimeve të naftës gjatë gjysmës së parë të vitit dhe nga nën-performanca e të ardhurave jotatimore kryesisht për shkak të zgjedhjeve të parakohshme. Totali i të ardhurave u rrit gjithashtu lehtë në Bosnje-Hercegovinë, me një rikuperim modest të kërkesës vendase. Shqetësimet në lidhje me ekonominë shqiptare rezultuan në një rënie të të ardhurave me 2.8 përqind në terma reale gjatë gjysmës së parë të vitit 2011. Tendenca të ngjashme vijuan të përshkonin ekonominë shqiptare edhe gjatë tremujorit të tretë, bashkë me një përmirësim të akcizave dhe kontributeve duke kompensuar një arkëtim relativisht të ulët të shumicës së taksave. Në Serbi, ulja e konsumit privat çoi në rënie të të ardhurave me 4.4 përqind gjatë gjysmës së parë të vitit, ndërsa kjo tendencë vijoi edhe në tremujorin e tretë. Po kështu, të ardhurat e Malit të Zi ranë me 5.3 përqind në terma reale, pavarësisht rritjes së përqindjeve të akcizës. Të ardhurat gjithsesi arritën të rikuperoheshin disi gjatë tremujorit të tretë, me shtimin e përpjekjeve për arkëtim të tyre.

Nga pikëpamja e shpenzimeve, qeveritë janë përpjekur të nxisin ekonominë këtë vit, por ndofta do t'u duhet të bëjnë përshtatje në të të ardhmen, në përputhje me kufizimet aktuale të financave.

Pjesa më e madhe e vendeve rritën shpenzimet, ndonëse cilësia e stimullit me të cilën kjo u arrit mund të jetë e debatueshme. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë rriti shpenzimet me afërsisht 6 përqind në terma reale gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, gjë që reflekton në një farë mase edhe përshpejtimin e shpenzimeve që mund lidhen edhe me zgjedhjet e parakohshme të 5 qershorit 2011. Rritja e shpenzimeve ishte targetuar drejt shpenzimeve kapitale, atyre në shëndetësi dhe transfertave. Këto tendenca erdhën duke u moderuar gjatë tremujorit të tretë, ku shpenzimet në terma reale pësuan rënie. Mali i Zi i rriti shpenzimet me afërsisht 3.8 përqind duke reflektuar gjerësisht ndryshimet në rregulloret e punës sipas të cilave u rritën pagat dhe pensionet. Këto ndryshime ka gjasa të ndikojnë shpenzimet për këto zëra gjatë periudhës afatmesme, si edhe kanë rritur përqindjen e rritjes së shpenzimeve gjatë tremujorit të tretë. Po kështu, Shqipëria rriti shpenzimet me 3.5 përqind në terma realë gjatë gjysmës së parë të vitit, ku transferat sociale përfaqësonin gjysmën e rritjes së shpenzimeve. Një kontroll më i fortë i shpenzimeve u

vendos gjatë tremujorit të tretë për të garantuar përmbushjen e objektivit për deficitin vjetor. Megjithatë, në Kosovë shpenzimet në përgjithësi u rritën me 3.3 përqind në terma reale, gjë që reflekton shpenzime të ngadaltë në tremujorin e parë. Shpenzimet u rritën ndjeshëm gjatë tremujorit të dytë si edhe gjatë kohëve të fundit duke reflektuar një valë të përhapjes së kapitalit, por edhe shpenzime më të larta për pagat dhe borderotë. Shpenzimet buxhetore të Bosnje-Hercegovinës u ulën në terma reale, gjë që pasqyrore një ulje të shpenzimeve për mallrat, shërbimet dhe subvencionet. Po kështu, u konstatua rënie e shpenzimeve në terma reale në Serbi, ndonëse përfitimet nga kufizimet në paga dhe pensione ishin të pamjaftueshme për të kompensuar nën-performancën e të ardhurave duke rezultuar në një deficit më të lartë. Për më tepër, përfitimet mund të jenë afatshkurtra, në kontekstin e indeksimit të pritshëm të pensioneve dhe pagave në muajin tetor.

Kutia 2: Madhësia e qeverive në rajonin e EJL6-ës

Madhësia e qeverive në ekonomi ndryshon shumë nga vendi në vend në EJL6 ku shpenzimet arrijnë nga me pak se 30 përqind e PBB-së deri në afro 50 përqind. Duke përdorur qoftë të ardhurat apo shpenzimet si njësi matëse, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia mund të klasifikohen në grupin e vendeve me qeveri të mëdha/të gjera, edhe në krahasim kjo madje me vendet e EU10-ës. Shqipëria dhe Kosova mund të klasifikohen në grupin e ekonomive me qeveri të vogël, ndërsa Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka një qeveri me masë të moderuar.

Tabela 8: Struktura e të ardhurave qeveritare në vendet e EJL6-ës, 2010

	ALB	BIH	KOS	MKD	MZI	SRB
	Përqindje e totalit të të ardhurave					
Taksat direkte	13.8	6.6	10.6	8.9	11.1	14.0
Taksat indirekte	49.3	44.4	66.2	40.5	46.0	42.2
Kontributet	16.5	35.1	0.0	27.3	28.9	26.4
Të ardhura të tjera	20.4	13.8	23.1	23.3	14.0	17.4
Të ardhurat totale	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
	Përqindje e PBB					
Taksat direkte	3.6	2.9	2.9	2.9	4.9	5.7
Taksat indirekte	12.9	19.7	18.2	13.4	19.5	17.3
Kontributet	4.3	15.6	0.0	9.1	12.2	10.8
Të ardhura të tjera	5.4	6.1	6.4	7.7	5.9	7.1
Të ardhurat totale	26.2	44.4	27.5	33.1	42.6	41.0

Burimi: Përlllogaritje të stafit bazuar mbi të dhëna të MF të vendeve të EJL6-ës, të dhëna të FMN-së për BIH.

Kontributet për sigurimet shoqërore duket të jenë faktori më i madh që kontribuon në këto diferenca kaq të mëdha të të ardhurave. Bosnje- Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia e sigurojnë një pjesë të mirë të të ardhurave qeveritare nga kontributet e sigurimeve shoqërore. Rrjedhimisht, transfertat sociale përfaqësojnë pjesën më të madhe të shpenzimeve (ndonëse këtu përfshihen edhe transfertat sociale relativisht bujare jokontributive si p.sh. ndihma ekonomike dhe përfitime të tjera). Nga ana tjetër, Shqipëria ka një skemë sigurimesh shoqërore shumë më të vogël, e cila lë zbuluar një pjesë të konsiderueshme të popullatës, ndërsa Kosova nuk ka një skemë të tillë (ndonëse ekziston një skemë private sigurimesh për pensionet). Rezultatet e dobëta të tregut të punës kanë shtrydhur fondet e skemave të sigurimeve shoqërore në pjesën më të madhe të vendeve të Evropës Juglindore duke kërkuar rritje të transfertave nga buxheti. Trysni të mbi skemat e sigurimeve shoqërore ka gjasa të shtohen me kalimin e viteve dhe do të lindë nevoja për reforma të sistemit. Rritja ekonomike në periudhën afatshkurtër mund të mos gjenerojë punësim, ndërsa rritja e moshës së popullatës do të krijojë presione të tjera në periudhën afatmesme dhe atë afatgjatë.

Kutia 2: vijon

Diferencat e konsiderueshme mbeten edhe kur përjashtohen kontributet. Ndërsa tarifatat statutores janë të ngjashme në vende të ndryshme të EJL6-ës ekzistojnë diferenca të mëdha përsa i përket performancës së të ardhurave. Pjesa më e madhe e të ardhurave tatimore në vendet e EJL6-ës sigurohet nga tatimet indirekte. Duke patur parasysh që tarifatat e TVSH-së dhe skedulet e tarifave doganore janë të ngjashme është e vështirë të interpretohen diferencat e mëdha që ekzistojnë. Ato mund të pasqyrojnë diferencat përsa i takon shkallës së informalitetit, bazës tatimore apo paaftësive në administrimin e taksave apo edhe taksa më pak të dukshme të cilat rrisin barrën fiskale të ekonomisë. Taksat direkte janë relativisht të vogla, gjë që pasqyron përqindjen e lartë të papunësisë dhe shkallën e lartë të informalitetit, por edhe reduktime të tarifës tatimore të kohëve të fundit, ndërsa ekonomitë e EJL6-së përpiqeshin të tërhiqnin investime. Rrjedhimisht, vendet e EJL6-ës tashmë kanë disa nga tatimet më të ulëta mbi të ardhurat në Evropë dhe Azinë Qendrore.

Nga pikëpamja e shpenzimeve, përmasat e sektorit qeveritar nxiten kryesisht nga transfertat sociale dhe pagat e sektorit publik. Qeveritë me një sektor të madh qeveritar (Bosnje-Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi) kanë shpenzime pagash të sektorit publik mbi 10 përqind të PBB-së, duke arritur afërsisht 13 përqind të PBB-së në Bosnje- Hercegovinë. Ndërsa Kosova dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë shpenzojnë më pak si përqindje e PBB-së për pagat e matur si përqindje e totalit të shpenzimeve, por shpenzimet e pagave gjithsesi përfaqëson një barrë të madhe për buxhetin. Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia gjithashtu shpenzojnë shumë më shumë fonde për transfertat sociale, kryesisht për pensionet. Me përjashtim të Kosovës, akordimi i shpenzimeve kapitale për vendet e EJL6-ës është relativisht i vogël.

Tabela 9: Struktura e shpenzimeve qeveritare në vendet e EJL6-ës, 2010

	ALB	BIH	KOS	MKD	MZI	SRB
	Si përqindje e shpenzimeve totale					
Pagat	18.1	26.5	24.4	22.6	23.3	22.6
Sigurimet sociale	29.3	31.5	13.0	29.3	29.0	42.7
Shpenzime të tjera korente	35.5	32.6	23.1	35.4	36.6	25.1
Shpenzimet kapitale	17.1	9.4	39.5	12.7	11.4	9.7
Shpenzimet totale	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
	si përqindje e PBB					
Pagat	5.3	12.9	7.4	8.0	11.0	10.
Sigurimet sociale	8.6	15.4	3.9	10.4	13.7	19.3
Shpenzime të tjera korente	10.4	15.9	7.0	12.6	17.1	12.4
Shpenzimet kapitale	5.0	4.6	11.9	4.5	5.3	3.5
Shpenzimet totale	29.3	48.9	30.2	35.6	47.1	45.6


Burimi: Përlllogaritje të stafit bazuar mbi të dhëna të MF të vendeve të EJL6-ës, të dhëna të FMN-së për BIH.

6. ZHVILLIMET E TREGUT TË PUNËS NË VENDET E EJL6

Përmirësimi i mundësive të punësimit mbetet një ndër sfidat kryesore afatgjata për vendet e EJL6-ës. Papunësia është në nivele përgjithësisht të larta në rajonin e EJL6-ës dhe në veçanti në mes të rinjve. Për më tepër, pjesa më e madhe e papunësisë është afatgjatë gjë që shkakton atrofizimin e aftësive për punë. Gjithashtu, disa prej vendeve karakterizohen nga popullata të moshuara, dinamika të theksuara migrimi dhe nivele të ulëta pjesëmarrjeje, në veçanti tek gratë. Për vendet më të prekura nga kriza (si p.sh. Serbia, Mali i Zi dhe Bosnje-Hercegovina) ka patur rënie të nivelit të punësimit dhe shtim të papunësisë qysh nga viti 2008 dhe këto tendenca ka gjasa të rikuperohen vetëm me rimëkëmbjen e ekonomive. Në përgjithësi ndikimi i krizës ka qenë disi më i butë sesa në vendet e EU10-ës.

Të gjitha vendet e EJL6-ës përjetuan një rritje të shpejtë deri në vitin 2008 të shoqëruar me rënie të niveleve të papunësisë, por që atëherë përvoja tregon ndryshe (Figura 32). Qysh nga viti 2008, papunësia në Serbi ka ardhur në rritje; në vitin 2008 ishte 14.4 përqind, ndërsa në vitin 2010 arriti në 20 përqind – niveli më i lartë qysh nga Sondazhi për Krahun e Punës (LFS) në vitin 1997. Në Bosnje-Hercegovinë është vënë re e njëjta tendencë: papunësia në vitin 2010 arriti në 27.2 përqind. Papunësia në Shqipëri u rrit si rezultat i krizës, por më pas ra në nivelin e 12.5 përqind në vitin 2010.¹¹ Pavarësisht rënies së produktivitetit në vitin 2009 dhe rimëkëmbjes të ngadalshëm qysh atëherë, në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë niveli i papunësisë qëndroi i pandryshuar gjatë viteve 2009/10 në nivelin 32 përqind. Në Kosovë nuk është bërë një LFS qysh nga viti 2009, kur papunësia ishte në nivelin 45 përqind, por pritet që kushtet e tregut të punës të jenë përmirësuar qysh asokohe në një mjedis ku ritmet e rritjes ekonomike ishin të moderuara dhe investimet publike (në infrastrukturë) në nivele të larta. Të dhënat e LFS-së për vitin 2010 (të disponueshme për të gjitha vendet, me përjashtim të Shqipërisë dhe Kosovës) tregojnë se papunësia vijoi të rritej në BIH (27.6 përqind), Mal të Zi (20.1 përqind) dhe në Serbi (me një shifër rekord prej 22.8 përqind). Në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, niveli i papunësisë ra në 31.3 përqind.

Figura 32: Përqindjet e papunësisë në EJL6



Burimi: Anketat e forcave të punës, Zyrat Kombëtare të Statistikave.

* Mesatarja e thjeshtë.

Shënim: Të dhënat e 2011 janë të tremujorit të dytë (Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Mali i Zi; Prill (BIH dhe Serbia).

Nivelet e papunësisë në EJL6 janë shumë më të larta sesa ato të BE-së, duke përfshirë këtu edhe vendet e EU-10-ës. Praktikisht në të gjitha vendet e EU-10-ës përpara krizës nivelet e papunësisë ishin në terma një shifrore. Edhe Bullgaria dhe Rumania që kanë nivele prodhimi të ngjashme me ato të vendeve të EJL6-ës ia dolën mbanë t'i sillnin nivelet e papunësisë në nën 6 përqind (2008).¹²

¹¹ Bazuar mbi të dhëna administrative.

¹²Disa nga diferencat në përqindjet e papunësisë i atribuohen diferencave në metodologjinë dhe cilësinë e sondazheve. Ndërsa të gjitha vendet e kanë zhvilluar tashmë Sondazhin për Krahun e Punës, shpeshësia dhe cilësia

Ajo që bie fort në sy në vendet e EJL6-ës është niveli i lartë i papunësisë midis të rinjve dhe niveli i ulët i pjesëmarrjes tek gratë. Papunësia tek të rinjtë është shumë më e lartë sesa për grupmoshat e tjera në të gjitha vendet, por është në veçanti alarmante në BIH dhe në Kosovë, ku shumica e të rinjve nga moshë 15-24 vjeç kërkojnë por nuk janë në gjendje të gjejnë një punë (Figura 33).

Çuditërisht, papunësia e personave pa ndonjë kualifikim të lartë profesional (me arsim fillor) është relativisht e ngjashme me nivelin mesatar të papunësisë. Në Serbi në fakt është edhe më e ulët sesa përqindja mesatare e papunësisë, gjë që sugjeron mungesën e punëve të një cilësie më të lartë.¹³ Përndryshe, papunësia për shkak të nivelit të ulët profesional në vendet e EU-10-ës është më shumë se dyfishi i nivelit mesatar të papunësisë. Rumania është i vetmi vend që bën përjashtim në këtë aspekt: përqindja e papunësisë për shkak të nivelit të ulët profesional ishte më e ulët sesa mesatarja në vitin 2010. Struktura e aftësive profesionale të personave të punësuar pasqyron strukturën e ekonomive përkatëse: bujqësia ku është e punësuar një përqindje e mirë e krahut të punës të Serbisë dhe Shqipërisë është një sektor që nuk kërkon nivel të lartë aftësish profesionale, e po kështu edhe industria tekstile ku është e punësuar një e treta e krahut të punës të sektorit të manufakturës të Maqedonisë.


Niveli i ulët i aftësive profesionale do të vazhdojë të ndikojë në performancën e tregut të punës dhe do të mbajë lart nivelin e varfërisë. Si në BIH ashtu edhe në Kosovë, afërsisht 10 përqind e popullatës në moshë pune nuk kanë mbaruar arsimin fillor, ndërsa kjo përqindje arrin në 6 përqind në Shqipëri dhe Maqedonia, 3 përqind në Malin e Zi dhe afërsisht 1 përqind në Serbi. Kuptohet që të varfrit janë të mbipërfaqësuar në këtë grup (si në Serbi ashtu edhe në Mal të Zi, të varfrit që janë në moshë pune kanë gjashtëfishin e mundësisë në krahasim me jo të varfrit që të mos kenë mbaruar arsimin fillor) dhe nuk është çudi që janë të përqendruar në sektorët dhe veprimtaritë që kërkojnë krah të ulët pune. Kështu p.sh. në Bosnje, 21 përqind e punëtorëve të varfër janë të punësuar në bujqësi përkundrejt 12 përqind që është kjo shifër për jo të varfrit. Evidenca të hollësishme nga Serbia tregojnë se sektorët që nuk kërkojnë kualifikim të lartë ishin më të prekurit nga kriza si përsa i përket humbjes së vendeve të punës ashtu edhe të pagave.

Papunësia në vendet e EJL6-ës është kryesisht afatgjatë. Mbi 80 përqind e personave që kërkojnë punë në BiH dhe në Mal të Zi, si edhe mbi 70 përqind e atyre në Serbi janë në tregun e punës (d.m.th të papunë) për më shumë se një vit dhe një përqindje e madhe prej tyre kanë qenë të papunë për tri apo më shumë vjet, me efekt tepër të rëndë për kualifikimin e tyre profesional dhe aftësinë e tyre për punë. Me gjasë situatë është e njëjtë edhe në vende të tjera të këtij rajoni, në veçanti në Kosovë, por për këtë nuk ka të dhëna.

e këtyre sondazheve varion. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Mali I Zi prodhojnë të dhëna për LFS-në çdo tremujor, ndërsa në Serbi këto të dhëna janë gjashtëmujore dhe në BIH vjetore. Të dhënat e LFS-së në këto prodhohen dhe publikohen në kohë. Nga ana tjetër, zyrat e statistikave në Shqipëri dhe Kosovë, supozohet të kenë LFS vjetor, por në vitin 2010 asnjëri nga këto vende nuk e bëri LFS-në. Përveç diferencave në shpërndarjen ka edhe diferenca që lidhen me cilësinë dhe metodologjinë e përdorur në sondazhe, ndonëse të gjitha vendet synojnë të jenë në përputhje me udhëzimet e ILO/EUROTAT-it. Kështu p.sh. gjatë përkufizimit të popullatës në moshë pune, të gjitha vendet përdorin përkufizim “15 vjeç e lart”, me përjashtim të Kosovës që përdor përkufizimin “15-64 vjeç”. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Serbia i përdorin të dy përkufizimet.

¹³ Për ironi, në Serbi niveli i papunësisë i personave të paarsimuar (11.7 përqind në vitin 2010) është më i ulët sesa për personat që kanë mbaruar studimet e larta (13.2 përqind). Megjithatë, shumica e atyre pa arsim formal nuk janë aktivë (nuk marrin pjesë në tregun e punës).

Figura 33: Total, përqindjet e papunësisë tek rinia (15-24) dhe aftësitë e ulët profesionale.



Burimi: Sondazhe të matjes së Krahut e Punës të zyrave kombëtare të statistikave.


Shënim: të dhënat janë të vitit 2010 me përjashtim të Shqipërisë dhe Kosovës (2009).

aktivitetit: përqindja e pjesëmarrjes të Serbisë ra nga 60.5 në vitin 2009 në 58.9 përqind në vitin 2011, ndërsa në vende të tjera ndryshimi ishte marginal (0.6 përqind rënie në BiH dhe në Mal të Zi).

Është me rëndësi të theksohet se në disa vende të EJL6-ës, gratë janë shumë të përjashtuara nga tregu i punës (Figura 34). Përqindja e aktivitetit dhe e punësimit të grave është tepër e ulët në Kosovë dhe në Bosnje-Hercegovinë.

Pjesëmarrja në tregun e punës në vendet e EJL6-ës është e ulët. Përqindja e popullatës aktive për punë është më e ulëta në BiH (44 përqind në vitin 2010), në Kosovë (48 përqind në vitin 2009) dhe me e larta në Shqipëri (62 përqind në vitin 2009) dhe në Serbi (59 përqind në vitin 2010). Përqindja e popullatës aktive për punë është shumë më e lartë në vendet e EU-10-ës, dhe akoma edhe më në pjesën tjetër të BE-së. BiH dhe Kosova, si edhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (me 57 përqind nivel aktiviteti) janë gjithashtu edhe vendet me papunësi më të lartë, gjë që do të thotë se këto vende kanë nivele punësimi shumë të ulëta (Figura 32). Mali i Zi ka një nivel aktiviteti relativisht të ulët (50 përqind në vitin 2010)¹⁴. Megjithatë, niveli i papunësisë është i ulët kështu që ai i punësimit është më i lartë sesa në pjesën më të madhe të vendeve të EJL6-ës. Kriza nuk pati ndikim të madh në përqindjet e

Figura 34: Pabarazitë gjinore janë të theksuara në shumicën e vendeve të EJL6-ës




Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave.

¹⁴ Krahu i punës i përkufizuar si popullata në moshë pune nga 15 vjeç e lart.

Prirjet e punësimit kanë reaguar në mënyrë të ndryshme ndaj krizës ekonomike globale në vende të ndryshme të EJL6-ës (Figura 35). Në Mal të Zi dhe në Serbi, përqindjet e punësimit kanë rënë qysh nga viti 2007, por rënia më e fortë ka qene për Malin e Zi. Përqindja e punësimit në BIH pësoi rënie gjatë periudhës 2009/10, por me një hap shumë më të ngadaltë. Këto janë edhe tri vendet që u goditën më shumë nga kriza. Nga ana tjetër, në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (e cila pati një kontraktim prej 0.9 përqind të PBB-së) dhe në Kosovë, niveli i punësimit vijoi të rritej gjatë gjithë krizës. E njëjta gjë parashikohet edhe për Shqipërinë, ekonomia e së cilës, ashtu si ajo e Kosovës vijoi të rritej gjatë krizës. Në Shqipëri dhe në Malin e Zi u konstatua një rritje e punësimit në gjysmën e parë të vitit 2011¹⁵, ndërsa në të gjitha vendet e tjera të rajonit u vu re një tkurrje e punësimit,¹⁶ ndonëse rritja kishte qenë pozitive për të gjitha.



Figura 35: Përqindjet e punësimit në vendet e EJL6-ës



Burimi: Sondazhe të matjes së Krahut ë Punës të zyrave kombëtare të statistikave.

Gjithashtu pati ndryshim edhe në mënyrën sesi tregjet e punës reagojnë ndaj tkurrjes së prodhimit gjatë krizës (Figura 36). Në pjesën më të madhe të vendeve, rënia e punësimit vijoi edhe gjatë vitit 2010, pavarësisht nga rimëkëmbjes së rritjes së produktivitetit: Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ishte i vetmi vend me ndryshim pozitiv në përqindjen e punësimit.¹⁷ Në Malin e Zi dhe në BIH u regjistruan rënie më të mëdha të nivelit të punësimit në vitin 2009 nga ç’ ishte parashikuar mbi bazën e tkurrjes së produktivitetit.

Figura 36: Ndryshimi vjetor i PBB-së reale përkundrejt ndryshimit të përqindjes së punësimit për vitin 2009 (në të majtë) dhe 2010 (në të djathtë)



Burimi: Zyrrat kombëtare të statistikave.

¹⁵ Bazuar në të dhëna administrative.

¹⁶ Për Kosovën nuk ka të dhëna.

¹⁷ Nuk ka të dhëna të anketës së punës për Shqipërinë dhe Kosovën për 2010.

Në vendet që prodhojnë të dhëna për LFS-në çdo tremujor në mënyrë të rregullt është e mundur të bëhet monitorimi i modeleve sektoriale ku ka humbje dhe krijim të vendeve të punës. Në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011 u humbën afërsisht 7,000 vende pune (neto)¹⁸: shërbimet dhe manufaktura ishin dy nga sektorët ku u regjistruan humbje të vendeve të punës (afërsisht 12,000 dhe 4,000 vende pune përkatësisht), ndërsa sektorët e bujqësisë dhe ndërtimit hapën vende të reja pune (përkatësisht 3,900 dhe 5,800 vende pune). Në Serbi, gjatë periudhës tetor 2010-prill 2011 u humbën mbi 100,000 vende pune, nga të cilat afërsisht 43,000 vende pune i takonin sektorit të shërbimit, 33,000 sektorit të bujqësisë, 17,000 manufakturës dhe 8,000 ndërtimit.

Kutia 3: Diferencat e taksave mbi punën në vende të ndryshme të EJL6-ës

Taksat e larta mbi krahun e punës kontribuojnë në informalitet dhe minojnë konkurrueshmërinë dhe rritjen ekonomike në disa vende të EJL6-ës. Ndërsa përqindjet e tatimit mbi të ardhurat janë në përgjithësi të ulëta (më e larta është 12 përqind, në Serbi), në disa vende kontributet sociale janë shumë të mëdha, gjë që çon në rritjen e përgjithshme të taksës mbi punën. Kontributet shoqërore arrijnë mbi 30 përqind të pagës bruto në BIH (Republika Srpska), Malin e Zi dhe në Serbi dhe 41.5 përqind në BIH (Federata BIH). Në Kosovë, vetëm 10 përqind e pagës bruto shkon për kontributet e sigurimeve shoqërore (për pensionin). Në vendet ku taksat mbi punën janë të larta kjo bën që si punëdhënësit ashtu edhe punëmarrësit të kalojnë në sektorin informal. Kjo dobëson qëndrueshmërinë e sistemeve të financimit të pensioneve dhe shëndetit. Gjithashtu ka edhe një efekt negativ mbi konkurrueshmërinë dhe rritjen ekonomike duke qenë se rrit kostot e krahut të punës¹⁹.

Kutia 3: vijon

Tabela 10: Përqindjet e kontributit shoqëror në vendet e EJL6-ës, si përqindje e pagës bruto

Vendi	Sigurimi Shoqëror	Sigurimi shëndetësor	Papunësia	Sigurime të tjera sociale	Total
Kosova	10.0	0.0	0.0	0.0	10.0
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	18.0	7.8	1.2	0.0	27.0
Shqipëria	21.6	3.4	0.9	2.0	27.9
BIH: <i>Republic Srpska</i>	18.0	12.5	1.0	1.5	33.0
Mali i Zi	20.5	12.3	1.0	0.0	33.8
Serbia	22.0	12.3	1.5	0.0	35.8
BIH: <i>Federation BIH</i>	23.0	16.5	2.0	0.0	41.5

Burimi: Banka Botërore.

Shënim: Përfundime të ndryshme dhe rregullore specifike për pagat/statusin zbatohen për përllogaritjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore; rrjedhimisht përqindjet e lartpërmendura nuk janë plotësisht të krahasueshme.

Rimëkëmbja e punësimit ka gjasa të kërkojë kohë. Sipas parashikimeve të FMN-së, bazuar mbi analizën e recesioneve në të gjithë botë gjatë tri dekadave të fundit duhen mesatarisht 3 tremujorë pas përfundimit të recesionit përpara se të nisë rimëkëmbja e punësimit, ndërsa papunësia e arrin kulmin e saj

¹⁸ Krahasimi me të dhënat e fundvitit 2010 nuk disponohet sepse në vitin 2011 u fut një metodologji e re (NACE Rev. 2) për të dhënat sipas sektorëve.

¹⁹ Në rajon, Mali i Zi ka pagën më të lartë mesatare (neto). Shqipëria dhe Kosova kanë pagat më të ulëta në rajon, të ndjekura nga Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë.

me një prapambetje deri në 5 tremujorë.²⁰ Ato vende të EJL6-ës që e pësuan më shumë nga kriza ekonomike globale e kapërcyen recesionin nga mesi i vitit 2010. Megjithatë, luhatjet aktuale globale mund të çojnë në vonesa në lidhje me përfitime të tjera. Për më tepër, rimëkëmbja e sektorit të ndërtimit mund të mos jetë aq i shpejtë në ato vende që tashmë po përballen me një ngadalësim të ritmeve të kreditimit dhe të investimeve në infrastrukturën publike. Rimëkëmbja e (eksporteve) industrinë e rëndë metalore do të varet nga kërkesa globale dhe çmimet, ndërsa rritja e eksporteve të prodhimeve tekstile do të nxitet nga zhvillimet e Evropës Perëndimore.

Ndërsa rritja e prodhimit parashikohet të përshpejtohet gjatë periudhës 2011/12, struktura e aktivitetit ekonomik mund të ndryshojë, gjë që do të influencojë edhe zhvillimet e tregut të punës. Kështu p.sh., rivitalizimi i sektorit të ndërtimit mund të mos jetë aq i shpejtë në ato vende që tashmë po përballen me një ngadalësim të ritmeve të kreditimit dhe të investimeve në infrastrukturën publike. Rimëkëmbja e (eksporteve) industrinë e rëndë metalore do të varet nga kërkesa globale dhe çmimet, ndërsa rritja e eksporteve të prodhimeve tekstile do të nxitet nga zhvillimet e Evropës Perëndimore.

²⁰ Evropa dhe Azia Qendrore: Knowledge Note 1, 2011: Rikuperimi i Punësimit në Evropë dhe Azinë Qendrore (Banka Botërore).


7. POLITIKAT STRUKTURE

Heqja e pengesave afatgjata strukturore do të **ndihmonte në hedhjen e bazave të një rritjeje të shëndoshë në rajonin e EJL6-ës.** Ndërsa sfidat e rritjes ekonomike ndryshojnë për vendet e veçanta të EJL6, fuqizimi i rritjes pa një rigjenerim të kërkesës vendase të nxitur nga zgjerimi i tepruar i kreditimit mbetet një sfidë për të gjitha këto vende. Siç mund të shihet edhe nga indeksi global i konkurrueshmërisë (Figura 37), vendet e EJL6-ës kanë shumë punë për të bërë për t'ia kapur vendet e EU15.

Disa prej vendeve e kanë pranuar nevojën për zbatimin e politikave të besueshme fiskale. Ndërsa rajoni i EJL6-ës në përgjithësi ka një përqindje më të ulët të shpenzimeve publike sesa vendet e EU10-ës apo EU15-ës, disa vende dallohen ndër të tjerat (Serbia, Mali i Zi dhe BIH) dhe do të duhet të ndjekin politika shpenzimesh të konsoliduara gjatë periudhës afatmesme. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë shquhet për plotësimin e objektivave të saj fiskale. Kosova ka hyrë në rrugën e menaxhimit gjithëpërfshirës të financave publike, prokurimeve dhe një program reformash të sistemit të pagave, ndërsa Mali i Zi dhe Serbia kanë bërë një reformë të pensioneve me qëllim forcimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të sistemeve të tyre të pensioneve. Edhe Serbia e ka pranuar nevojën për vendosjen e rregullit fiskal përmes ligjit për përgjegjësinë fiskale dhe ka ngritur Këshillin Fiskal që ka marrë rolin e mbikëqyrjes së ndikimit fiskal të legjislacionit. Bosnje-Hercegovina duhet të përmbushë Marrëveshjen (Stand-By Arrangement) (SBA) me FMN-në duke qenë se ky do të ishte një sinjal pozitiv i angazhimit të autoriteteve ndaj politikave të kujdesshme makro-ekonomike dhe do të ndihmonte në sigurimin e mbështetjes të qenësishme nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Reformat e mjedisit të biznesit kanë qene prioritet për rajonin EJL6-ës gjatë dy viteve të fundit. Përmirësimi i mjedisit të biznesit është pozitiv për rritjen ekonomike dhe konkurrueshmërinë, si edhe ka rezultuar të jetë përpjekja më e lehtë nga këndvështrimi I ekonomisë politike. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Mali i Zi janë dy prej vendeve që kanë bërë përmirësimet më të mëdha në rajon, madje edhe në nivel global, të pranuar edhe nga treguesit e raportit Të bësh Biznes (Doing Business). Ka patur edhe disa vende të tjera të cilat kanë ecur përpara me disa reforma të përzgjedhura në lidhje me mjedisin e biznesit – kryesisht në lidhje me shkurtrimin e procedurave të regjistrimit (të kompanive dhe të pronave) (Tabela 12), si edhe në lidhje me punën për kuadrin rregullator (BIH) dhe vlerësimin e ndikimit rregullator (Shqipëri). Megjithatë, lëshimi i lejeve dhe moszbatimi siç duhet I kontratave vazhdojnë të pengojnë mjedisin e biznesit. Zbatimi i legjislacioni dhe reformat në Gjyqësor dhe anti-korrupsion ende mbeten prioritet mbi prioritetet, ndërsa impakti I tyre do të ndjehet vetëm gjatë periudhës afatmesme.

Figura 37: Indeksi i konkurrueshmërisë globale 2011-2012



Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, perlloraritjet e stafit te Bankes Botërore.

Kutia 4: Prioritet e Reformave

Menaxhimi makroekonomik- imediat

- Financat publike – forcimi i PBA-ve dhe garantimi i përputhshmërisë me planet e konsolidimit fiskal (si p.sh. ligji për Përgjegjësinë Fiskale në Serbi); krijimi i hapësirës fiskale për t'i paraprirë tronditje të mundshme fiskale në të ardhmen;
- Forcimi i përputhshmërisë tatimore dhe zgjerimi i bazës tatimore;
- Sektori financiar – forcimi i autoriteteve mbikëqyrëse dhe kuadrit ligjor.

Reformat në lidhje me mjedisin e biznesit – përfitime të shpejta

- Shkurtim i procedurave të regjistrimit;
- Plotësimi i gijotinës rregullatorë dhe Vlerësimeve të Ndikimit Rregullator;
- Reformimi i sistemit të zbatimit për t'i dhënë zgjidhje mentalitetit të mospagimit;
- Përfundimi i programeve të privatizimit.

Sektorët socialë – shqetësime imediate, impakt i vonuar

- Trajtimi/zgjidhja e sfidave demografike (rritja e moshës mesatare) në reformat për pensionet;
- Përshpejtimi I reformës në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale;

Mungesa e fleksibiliteti në tregun e punës dhe mospërputhja me kualifikimin profesional-shqetësime imediate, impakt i vonuar

- Zhvillimi i reformës për edukimin profesional, të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe reforma në sektorin e arsimit terciar

Liberalizimi i tregtisë dhe shërbimeve – program afatmesëm, ndikim imediat

- Liberalizimi i industrive të rrjetit (si p.sh logjistika, energjia), privatizimi i SOE-ve dhe heqja e barrierave jotarifore;

Reformat në lidhje me qeverisjen – reforma në kuadrin afatgjatë, impakt i shtyrë/vonuar

- Përshpejtimi I reformave në Gjyqësor dhe i atyre anti-korrupsion në të gjithë rajonin;
- Përmirësimi i efikasitetit, integritetit dhe transparencës së administratës publike

Tabela 11: Reformat e të bërit biznes


Vendi	Të bërit biznes 2012 (prej 183 vendeve)	Reformat më të fundit
Maqedonia, RIJ	22	Procedurat që kanë të bëjnë me lejet e ndërtimit janë lehtësuar duke i transferuar proceset e mbikëqyrjes në sektorin privat dhe thjeshtëzimin e procedurave. Ka bërë regjistrimin e pasurisë më të lehtë duke ulur tarifat e noterit dhe zbatimin e afatit kohor të përcaktuar në Ligjin për kadastrën të pasurive të patundshme. Krijimi i një zyre krediti private ka përmirësuar sistemin e informacionit të kredive. Dhe ndryshimet legjislative kanë rritur transparencën e procesit të falimentimit.
Mali i Zi	56	Mali i Zi ka bërë hapjen e biznesit më të lehtë duke zbatuar një one-stop. Ka bërë pagimin e taksave më të lehtë dhe më pak të kushtueshme për firmat me heqjen e një takse, duke e zvogëluar kontributet e sigurimeve shoqërore, si dhe bashkimi i disa forma në një kthim të unifikuar. Së fundi, kaloi një ligj të ri falimentimit që paraqet riorganizimit të procedurave të likuidimit dhe vendos afate për këto procedura. Ligji parashikon mundësinë e shërimit të kërkesave të kreditorëve të siguruar dhe të shlyerjes para përfundimit të procedurës së falimentimit të gjithë.
Shqipëria	82	Shqipëria ka bërë regjistrimin e pasurisë më të lehtë duke vendosur një afat kohor për regjistrimin e tokës për të regjistruar një titull. Nga ana tjetër, marrja me lejet e ndërtimit u bë më e vështirë, sepse autoriteti kryesor përgjegjës për lëshimin e lejeve të ndërtimit nuk është takuar që nga prilli 2009.
Serbia	92	Serbia bëri transferimin e pronave të shpejtë duke i ofruar një alternativë të përshpejtuar. Gjithashtu miratoi legjislacionin që futi kërkesa profesionale për administratorët e falimentimit dhe që rregullon kompensimin e tyre.
Kosova	117	N/A
BIH	125	BiH bëri marrjen me lejet e ndërtimit më të lehtë duke arritur plotësisht të digjitalizojë dhe modernizojë regjistrin e tokës dhe kadastrës. Përveç kësaj, hapja e një biznesi u bë më e lehtë duke zëvendësuar lejen e kërkuar të shfrytëzimit me një njoftim të thjeshtë të fillimit të aktivitetit dhe duke riorganizuar procesin për marrjen e një numri të identifikimit tatimor.

Burimi: Banka Botërore.

Privatizimi dhe partneriteti publik- privat janë dy elemente që janë pranuar si sfida të rëndësishme të financave publike dhe në rast se trajtohen siç duhet mund të jenë një instrument efikas për ristrukturimin e ndërmarrjeve shtetërore që janë tejet të varura nga ndihma shtetërore. Rajoni, me afërsisht 65 përqind të PBB-se të krijuar nga sektori privat ka ende shumë punë për të bërë për të arritur vendet e EU10-ës, ku përqindja e sektorit privat në raport me PBB-në është mesatarisht 80 përqind (Figura 38). Shqipëria nisi një program gjithëpërfshirës privatizimesh në vitin 2011, me qëllim shitjen e afërsisht 1,300 ndërmarrjeve shtetërore, si edhe forcoi ligjin për konkurrencën, por shitja e disa kompanive kryesore (në fushën e naftës, sigurimeve) ka ngecur në vend numëro. Po kështu në Shqipëri dhe në Mal të Zi janë dhënë një numër koncesionesh me qëllim zgjerimin e hidrocentraleve. Ato mbeten ende për t'u zhvilluar në projekte konkrete. Në BIH, procesi I privatizimit duhet të përshpejtohet. Përshpejtimi I procesit do të sjellë si rezultat investimet e aq shumë pritura, bashkë me kualifikime të reja profesionale dhe teknologji, si edhe mund të nxisin ritmet e rritjes ekonomike, por do të kërkojë ndërmarrjen e disa vendimeve politikisht të vështira nga autoritetet përkatëse. Procesi I privatizimit i aseteve të mbetura shtetërore ka ngecur në vend në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Mal

të Zi, kryesisht për shkak të mungesës së interesit nga investitorët. Praktikisht, pas disa përpjekjeve të dështuara për ristrukturimin e konglomeratit të aluminit në vend (KAP) në tetor të vitit 2010, qeveria rimori pronësinë e 29% të aksioneve nga pronari rus i shumicës të kompanisë Central European Aluminum Company.

Figura 38. Përqindja e sektorit privat ndaj PBB



Burimi: Raporti i Tranzicionit, BERZH.

Tabela 12: Treguesi i performancës së logjistikës, 2010

Vendi	Indeksi (LPI)	Dogana	Infrastruktura	Dërgesat ndërkombëtare	Aftësitë logjistike	Ndjekja dhe gjurmimi	Kostot e brendshme logjistike	Shpejtësia
Kroacia	2.71	2.4	2.5	2.7	2.8	2.5	3.1	3.5
BIH	2.46	2.3	2.3	2.5	2.4	2.3	3.4	3.0
Maqedonia, RIJ	2.43	2.0	2.3	2.7	2.3	2.5	3.0	2.8
Serbia de Mali i Zi	2.28	2.3	2.2	2.3	2.3	2.1	3.1	2.5
Shqipëria	2.08	2.0	2.3	2.3	2.0	1.7	2.8	2.1
Slllovakia	2.92	2.6	2.7	3.1	3.0	2.9	3.1	3.3
Rumania	2.91	2.6	2.7	3.2	2.9	2.9	2.6	3.2
Bulgaria	2.87	2.5	2.5	2.8	2.9	3.1	2.9	3.6
Evropa q. dhe Azia (mesatarja)	2.59	2.4	2.4	2.6	2.5	2.6	3.0	3.0
BE-10 (Mesatarja)	3.0	2.7	2.8	3.0	3.0	3.0	3.1	3.5
EJL6 Mesatarja	2.4	2.2	2.3	2.5	2.4	2.2	3.1	2.8


Burimi: Banka Botërore

Liberalizimi i tregtisë në rajon ka ecur në përgjithësi mirë, kryesisht përmes anëtarësimit në OBT dhe CEFTA, si edhe përmes zbatimit të Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit (MSA) me BE-në. Megjithatë, ka vend për përmirësim në lidhje me disa prej politikave tregtare që lidhen me barrierat jotarifore, nivele të tepruara në disa linja tarifore dhe liberalizimin e rrjetit. Vjelja e përfitimeve të një tregu më të gjerë kërkon një integrim të thellë rajonal që shkon përtej tregtimit të mallrave. Studimet e kohëve të fundit japin fakte të efekteve pozitive të rritjes ekonomike, qoftë direkte dhe indirekte, të tregtimit të shërbimeve.²¹ Eksportet e shërbimeve dhe sofistikimi i tyre nxisin rritjen, ndërsa politikat e shërbimeve kanë një korrelacion pozitiv me produktivitetin e firmave prodhuese që varen nga shërbimet si inpute (si p.sh. në Republikën Çeke dhe në Indi). Integrimi i tregjeve të mallrave dhe shërbimeve do t'u bëjë të mundur ekonomive të vogla të CEFTA-s të bëhen pjesë jo vetëm rrjeteve rajonale por edhe globale të furnizimit dhe rrjeteve të prodhimit, ku rajoni i EJL6-ës është shumë pas vendeve të përparuara (Tabela nr. 13). Kjo nga ana e vet do të ulte kostot për konsumatorët dhe do t'i bënte këto ekonomi më tërheqëse ndaj investimeve të huaja. Për më tepër, duke qenë se integrimi rajonal është një parakusht për anëtarësimin në BE, hapja e tregut të shërbimeve rajonale do t'i përgatisë ekonominë e CEFTA-s për të funksionuar brenda tregut të vetëm të BE-së.

Pavarësisht nga progresi i dekadës së fundit, tregjet e punës mbeten relativisht jofleksibël. Siç theksohet në seksionin 6 në lidhje me zhvillimet e tregjeve të punës, vendet e EJL6-ës vazhdojnë të kenë nivele të ulëta pjesëmarrjeje dhe punësimi. Të gjitha vendet e EJL6-ës ende përballen më një shkallë të lartë informaliteti, mospërputhje të kualifikimeve profesionale me vendin e punës dhe sisteme inefficente të sigurimeve shoqërore. Ndër reformat kryesore që do të mbështesnin një pjesëmarrje më të madhe të krahut të punës mund të përfshihen: rritja e moshës ligjore për daljen në pension dhe ulja e stimuljeve për daljen e parakohshme në pension; nxitja e të mësuarit gjatë gjithë jetës; reduktimi i ngurtësive të rregulloreve të punës dhe sigurimi i stimuljeve për punësim përmes mbrojtjes të integruar social dhe ndihmës ekonomike. Reformat e pensioneve kanë ecur përpara në Serbi dhe në Mal të Zi, të cilat në vitin 2011, ndër të tjera, rritën moshën e daljes në pension nga 65 vjeç për burrat dhe 60 për gratë përkatësisht në 67 vjeç në 2025 dhe 2041, respektivisht.

Gjatë vitit 2011, program i anëtarësimit në BE në një shkallë të madhe ka drejtuar përpjekjet e reformave në vendet e EJL6-ës dhe ka përmirësuar perspektivën e anëtarësimit. Si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE, qeveria malazeze ka zbatuar një Plan Veprimesh në shtatë fusha të reformës në qeverisje dhe antikorrupsion dhe po parashikon të nisë procesin e negociatave. Në Serbi, përpjekjet dhe puna intensive për përfitimin e statusit të vendit kandidat për në BE (që parashikohet të miratohet në dhjetor nga Këshilli i Evropës) gjithashtu sollën përmirësime që lidheshin me rendin dhe qeverisjen. Çuarja përpara e procesit të anëtarësimit në BE për Shqipërinë dhe Bosnje-Hercegovinën është me shumë rëndësi. Progresi i Shqipërisë drejt integritimit në BE ka ngelur në vend gjatë vitit të kaluar, ndërsa situata e tejzgjatuar e pazgjidhur politike në BiH ka çuar në vonesa të mëtejshme në aspektin e reformave strukturore, duke përfshirë ato që kërkojnë nga programet e mbështetjes buxhetore të FMN-së, Bankës Botërore dhe BE-së.

Figura 39: Treguesit e qeverisjes, Banka Botërore



Burimi: Banka Botërore


²¹ Handjiski dhe Sestovic (2011), *Barrierat ndaj tregtisë në shërbime në rajonin e CEFTA-s*

8. PERSPEKTIVAT DHE POLITIKAT

Rritja ekonomike në të ardhmen


Zhfillimet afatshkurtra për vendet e EJL6 varen së tepërmi nga faktorë që janë kryesisht përtej kontrollit të qeverive të vendeve të EJL6. Në kohën e hartimit të këtij raporti, liderët e vendeve kryesore të BE-së ende po përpiqen të zbatojnë një grup politikash të besueshme me qëllim vendosjen e një procesi sistematik për menaxhimin e borxhit sovran në Greqi, me qëllim parandalimin e përhapjes së rreziqeve në ekonomitë e tjera të eurozonës, për të rikapitalizuar bankat e prekura nga shkurtimet e mundshme të borxhit sovran dhe për krijimin e një kuadri më të unifikuar dhe efektiv për shtetet anëtare të zonës së euros. Pasiguria në lidhje me aftësinë e tyre për të përmyllur me sukses këtë proces, si edhe një sërë rëniesh nga kategoria, bashkë me luhatjet e tregut dhe pasiguritë ndaj politikave amerikane të deficitit kanë lëkundur besimin e investitorëve dhe bizneseve dhe i kanë bërë konsumatorët të jenë mosbesues. Shumica e analistëve i kanë ulur parashikimet e tyre për rritjen globale në SHBA dhe BE me një përqind ose edhe më shumë. Parashikimet tona për rritjen ekonomike në EJL6 janë 2.5 përqind në vitin 2011 dhe 2.5 përqind në vitin 2012, shifra këto që janë shumë më poshtë përqindjeve të periudhës përpara vitit 2008 prej 6-10 përqind (Figura nr. 43). E në rast të një dështimi të mundshëm të politikë-bërësve dhe një përkeqësimi të krizës, performanca e vendeve të EJL6-ës dhe pjesës tjetër të globit mund të rezultonte shumë më negative.

Figura 40: Ndryshimi i parashikimeve të rritjes globale për vitin 2012 (prill dhe shtator 2011)




Burimi: FMN WEO.

Figura 41: Indeksi i bursave MCSI Jan2010=100




Burimi: Bloomberg.

Figura 42: Indeksi i besimit te konsumatorit



Burimi: Bloomberg.

Figura 43: ritmet e rritjes reale te PBB-së për vendet e EJL6 (%)




Burimi: Zytrat kombëtare të statistikave dhe parashikimet e stafit të Bankës Botërore.

Rreziqet

Ndërkohë që nuk ka një tregues objektiv të nivelit të rrezikut, shumica e vëzhguesve priren të klasifikojnë si rrezik të lartë makro-ekonomik të tregjeve në zhvillim të avancuara, deficite fiskale apo të jashtme që e tejkalojnë afërsisht 5-6 përqind të PBB-së dhe borxhin publik apo të jashtëm mbi 50-60 përqind të PBB-së. Rreziku është i ulët kur vlerat e këtyre treguesve janë përkatësisht nënë 3-4 dhe 30-40 përqind të PBB-së respektivisht. Për analizën tonë, ne kemi përdorur nivelet e mëposhtme të rreziqeve makro:

- Deficiti fiskal: I LARTË > 5 përqind i PBB; 3 < I MESËM < 5 përqind i PBB, I ULËT < 3 përqind i PBB
- Borxhi publik: I LARTË > 60 përqind e PBB-së; 40 < I MESËM < 60 përqind i PBB, I ULËT < 40 përqind i PBB
- Deficit i llogarisë rrjedhëse: I LARTË > 6 përqind i PBB; 4 < I MESËM < 6 përqind i PBB; I ULËT < 4 përqind i PBB
- Borxhi i jashtëm: I LARTË > 60 përqind i PBB; 40 < I MESËM < 60 përqind i PBB; I ULËT < 40 përqind i PBB
- Hapja e tregtare: I LARTË > 100 i PBB; 60 < I MESËM < 100 përqind i PBB; I ULËT < 60 përqind i PBB
- Financimi i huaj i bankave: I LARTË > 15 përqind i PBB, 10 < I MESËM < 15 përqind i PBB; I ULËT < 10 përqind i PBB.

Figure 44: Indikatorët rreziqeve



Burimi: Vlerësime të stafit të BB.

Mund të dallohen disa karakteristika për vendet e EJL6 në lidhje me këta tregues:

- Deficiti fiskal është poshtë, por gjithsesi afër referencës për risk të lartë në Malin e Zi dhe Serbi. Këto dy vende, bashkë me Bosnje-Hercegovinën janë goxha sipër nivelit të Maastrihit. Një çështje me rëndësi në këtë kontekst është nëse është i mundur financimi i deficiteve në këto nivele.
- Deficitet e llogarive rrjedhëse janë shumë të larta në krahasim me përqindjen e referencës së riskut të lartë në Kosovë dhe Mal të Zi dhe në një shkallë më të vogël në Shqipëri.
- Si grup, vendet e EJL6-ës kanë një shkallë modeste të hapjes së tregut, dhe vetëm Maqedonia është mbi përqindjen e referencës. Ndonëse kjo përbën një rrezik ajo është pjesërisht pasojë e shkallës së vogël të ekonomive. Për më tepër, ajo reflekton politikat që kanë për qëllim integrimin me BE-në.
- Shqipëria dhe Mali i Zi dallohen mes vendeve të tjera për nivelet e larta të borxhit publik (duke përfshirë borxhin e garantuar publik) që janë afër përqindjes së referencës për risk të lartë.
- Të gjitha vendet, me përjashtim të Kosovës dhe Shqipërisë kanë nivele relativisht të larta të borxhit të jashtëm, ku Mali i Zi dhe Serbia janë brenda rrezes së riskut të lartë. Ndonëse një pjesë e këtij borxhi është ndaj huadhënësve zyrtarë, ai përbën një rrezik rrefinancimi në rast të një ngushtimi të mëtejshëm të aksesit ndaj tregut.
- Bosnje-Hercegovina dhe Serbia janë veçanërisht të rrezikuara për shkak të vartësisë në një shkallë të larta nga financimet e huaja të bankave.

Politikat

Vendet e EJL6-ës nuk parashikojnë ndonjë axhustim fiskal substancial për vitin 2012. Në parashikimet fillestare të Malit të Zi parashikohet një reduktim i ndjeshëm i deficitit fiskal për vitin 2012, kryesisht në kurriz të prerjes së shpenzimeve; megjithatë, këto parashikime kanë ndryshuar kohët e fundit dhe sipas tyre deficit për vitin 2012 parashikohet të jetë afërsisht -2 përqind e PBB-së. Serbia ka parashikuar një axhustim tepër modest, tek afërsisht 0.6 p.p. të PBB-së, ndonëse struktura e axhustimit ende mbetet për t'u përcaktuar. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka gjasa të ruajë objektivin e vet të deficitit tek afërsisht 2.5 përqind e PBB-së. autoritetet përkatëse janë të angazhuara për të vijuar me një kontroll të rreptë mbi konsumin publik dhe për akordimin e më shumë fondeve për shpenzimet kapitale. Po kështu, edhe Shqipëria ka gjasa të ruajë objektivin e vet për deficitin për vitin 2012 në shifrën 3 përqind të PBB-së. Programi Buxhetor Afatmesëm i Kosovës për periudhën 2012-14 (PBA) parashikon një zgjerim të mëtejshëm të deficitit në shifrën afërsisht 3.6 përqind në vitin 2012, duke qenë se pritet të vijojnë nga zbatimi projektet në infrastrukturë.

Pjesa më e madhe e vendeve të EJL6-ës kanë përfshirë në parashikimet e tyre fiskale për vitin 2012 një përshejtim të veprimtarisë ekonomike. Megjithatë, në rast të trazirave më të mëdha, rritja ekonomike do të ndikohet ndjeshëm dhe do ushtrojë trysni të reja në llogaritë fiskale. Njësoj si gjatë krizës të vitit 2009, rritja ekonomike dhe performanca fiskale ka shumë gjasa të jenë heterogjene. Megjithatë, shenjat e kohëve të fundit të një rritjeje ekonomike më të dobët në Shqipëri dhe niveli I saj ri borxhit relativisht të lartë nënkupton se edhe Shqipëria kësaj here mund të preket negativisht. Ndërsa duket se ka vend për huamarrje të brendshme, kjo mund të shkaktojë tkurrje të financimeve për sektorin privat. Aksesit ndaj tregjeve të jashtme do të vijojë të mbetet i vështirë. Për vendet me kurse fikse shkëmbimi, nxitja e kërkesës do t'i mbajë lart deficitet tregtare dhe mund të vërë në rrezik stabilitetin makro-ekonomik.

Pak vende të EJL6-ës kanë ende hapësirë për të akomoduar një përkeqësim të krizës përmes stimujve fiskalë apo edhe përmes vënies në funksionim të elementëve stabilizues automatikë. Rrjedhimisht ka disa vende që duhet të përshejtojnë konsolidimin fiskal, e në veçanti reformat që kanë për qëllim përmirësimin e qëndrueshmërisë afatgjatë dhe krijimin e rezervave fiskale. Gjatë krizës globale financiare të vitit 2008, qeveritë e vendeve të EJL6-ës kishin hapësirë për të prezantuar politika fiskalë anti-ciklike, me qëllim zbutjen e ndikimit të krizës. Megjithatë, tashmë vetëm Maqedonia mund të ketë hapësirë për një politikë fiskale akomoduese, në rast të një përkeqësimi të krizës. Në pjesën tjetër të vendeve pati një rritje të borxhit publik dhe imbalancave fiskale gjatë krizës së mëparshme dhe hapësira për stimuj është ezauruar. Duke patur parasysh rritjen e vëmendjes së tregjeve ndaj qëndrueshmërisë fiskale dhe të borxhit, disa vende duhet të marrin në konsideratë një forcim të kujdesshëm të politikës fiskale, në veçanti përmes reformave që kufizojnë ndikimin imediat mbi rritjen e produktivitetit, por edhe që thellojnë qëndrueshmërinë afatgjatë. Fushat kryesore të fokusit duhet të jenë pensionet dhe pagat. Vendet që kanë përqindje fleksibël të kursit të shkëmbimit duhet t'i lejojnë këto të fundit të axhustohen dhe të përdorin ndërhyrje për forcimin e lëvizjeve të tregut në vend që t'ia lënë gjërat rastësisë.

Pavarësisht nga turbulencat e kohëve të fundit dhe rritja e pasigurive në lidhje me të ardhmen afatshkurtër, një model rritjeje që është i bazuar në një integrim më të madh me BE-në përsa i përket financave, tregtisë, tregjeve të punës dhe institucioneve mbetet integrimi më i mirë për rajonin e EJL6-ës. Dy janë mësimet kryesore për EJL6 nga e kaluara jo fort e largët, të cilat do t'i ndihmojnë vendet e EJL6-ës për të shfrytëzuar më mirë përfitimet e këtij modeli rritjeje gjatë periudhës afatmesme. Së pari, rritja ekonomike në të ardhmen do të duhet të nxitet kryesisht dhe më shumë nga

investimet dhe produktiviteti që rrit konkurrueshmërinë dhe kapacitetet produktive, dhe më pak nga konsumi I financuar nga jashtë dhe nga investimet ne prona të paluajtshme dhe nga flluska të tjera aktivesh që ishin karakteristika për periudhën përpara krizës së vitit 2009. Së dyti, për pjesën më të madhe të vendeve të EJM-ës ende mbetet përpara një program i gjatë I papërfunduar reformash strukturore. Këto duhet të trajtohen në mënyrë urgjente për të përfituar nga aksesimi në tregje, nga investimet e huaja direkte dhe nga remitancat që ofrohen nga integrimi, duke ndërtuar në këtë mënyrë një rritje ekonomike të qëndrueshme.

Speciale # 1.

Aftësi, jo thjesht diploma; ajo që ka rëndësi në fund të fundit ka të bëjë me kualifikimin profesional të të punësuarve dhe jo diplomat që ata kanë marrë. Për ta mbyllur këtë hendek të kualifikimeve profesionale në fillim duhet të mbyllim hendekun e dijes.

PËRMBLEDHJE

Në mënyrë paradoksale, për një rajon me nivel arsimor të lartë dhe në rritje (të matur sipas numrit të viteve të shkollimit), si edhe me një cilësi të lartë të arsimit në vitet e para të shkollimit vihet re një mungesë kualifikimesh profesionale që ka dalë si një nga pengesat më serioze për zgjerimin e firmave në vendet e EJK6-ës. Një botim i kohëve të fundit i Bankës Botërore – i cili merr në studim 29 vende në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (ECA) – i titulluar **Jo thjesht diploma, por kualifikime profesionale (Jo thjesht diploma, por kualifikime profesionale)** përpiqet t’u japë përgjigje pyetjeve të tilla si: Përse firmat ankohen gjithnjë e më shumë se nuk mund të gjejnë krah pune me kualifikimet e duhura profesionale? Çfarë mund të bëjnë vendet për ta mbyllur hendekun e mungesës së kualifikimeve profesionale?

Speciale #1.

Aftësi, jo thjesht diploma

Një ndër mesazhet kryesore të botimit të Bankës Botërore, me titull Aftësi, **jo thjesht diploma**²² është që politikë-bërësit nuk mund të hartojnë/përpilojnë politika për mbylljen e hendekut të mungesës së kualifikimeve profesionale, po nuk mbyllën më parë hendekun e informacionit mbi aftësitë profesionale. Në rajon ka të dhëna mbi numrin e studentëve që përfundojnë shkollën e lartë (d.m.th sa diploma janë shpërndarë), por nuk ka të dhëna të krahasueshme në nivel ndërkombëtar në lidhje me faktin nëse këta të diplomuar kanë apo jo kompetencat dhe kualifikimet e duhura profesionale për tregun e punës. Për ta mbyllur këtë hendek nevojiten më shumë teste për ta matur kualifikimet profesionale të studentëve, diplomantëve dhe të rriturve. Për më tepër, për të kuptuar më mirë tranzicionin (apo mungesën e tranzicionit) e të diplomuarve nga institucioni arsimor në një vend pune ka nevojë për zhvillimin e sondazheve/studimeve që ndjekin diplomantët 1-5 vjet pas përfundimit të shkollës. Po kështu, vetë kompanitë dhe firmat duhet të organizojnë sondazhe të hollësishme në lidhje me kualifikimet profesionale që nevojiten, por që ato nuk mund t'i gjejnë: a kemi të bëjmë me aftësi teknike, njohëse, jonjohëse (socio-emocionale) që mungojnë? Vetëm duke kuptuar më mirë atë që firmat duan dhe atë që ofrohet nga institucionet arsimore politikë-bërësit mund të hartojnë politika efektive për të përmirësuar përputhshmërinë.

Nuk janë vetëm politikë-bërësit ata që kanë nevojë për informacion më të mirë; firmat/kompanitë dhe studentët kanë nevojë për informacion më të mirë për t'u ardhur atyre në ndihmë për një vendim-marrje të informuar mirë dhe për të qenë për t'i sjellë arsimin dhe trajnimin në një linjë me kurikulat dhe me nevojat e tregut të punës. Një nga vendimet më të mëdha dhe më të rëndësishme në jetën e një të riu është ai që lidhet me arsimimin e tij, çfarë të studiojë dhe ku të studiojë. Aktualisht, kjo vendim-marrje në vendet e EJL6-ës po kryhet me informacion relativisht të kufizuar në lidhje me perspektivën e mundshme të punësimit dhe të të ardhurave.

Sfida që ka të bëjë me aftësitë profesionale është reale: firmat e kanë shumë vështirë të gjejnë krah pune të kualifikuar


Sondazhet e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Sondazhi i Bankës Botërore mbi Performancën e Mjedisit të Biznesit dhe Ndërmarrjeve (BEEPS) tregojnë se perceptimi i firmave në lidhje me kufizimet për aftësitë profesionale pësoi një ndryshim dramatik në vendet e ECA-s gjatë vitit 2005.³ Në vitin 2008, mungesa e krahut të kualifikuar të punës renditej në vendin e dytë përta i takon pengesave ndaj rritjes ekonomike sipas sondazhit BEEPS në të gjitha vendet e rajonit, menjëherë pas përqindjeve të taksave (Figura 1). Mesatarisht, 30 përqind e firmave i konsideronin arsimin dhe kualifikimin profesional si një pengesë madhore apo e rëndësishme gjatë vitit 2008. Përqindja më e lartë e firmave që raportojnë pengesa I përket vendeve të CIS me të ardhura mesatare, ku mbi 40 e firmave ishin të pakënaqura nga disponibiliteti i krahut të kualifikuar të punës. Një përqindje më e vogël e firmave në EJL6 raportuan nivele të ngjashme pakënaqësie, ndërsa perceptimet mes vendeve të EU10 ndryshonin shumë nga njëra-tjetra (të dhënat e BEEPS-it për vitin 2008).

Ndonëse firmat në EJL duket të jenë më pak të penguar nga ky hendek sesa vendet e tjera në rajon më gjerë, megjithatë ka vend për shqetësim. Së pari, përqindja e firmave që raportojnë si problem “niveлин

²² Kjo Speciale bazohet në Raportin e Bankës Botërore me titull “Aftësi, jo thjesht diploma: Menaxhimi i Arsimit për të arritur rezultate në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore”. Raportin mund ta gjeni në këtë adresë interneti <http://www.worldbank.org/eca/skills>

arsimor dhe kualifikimin profesional të krahut të punës” është rritur nga viti 2005 dhe 2008. Në vitin 2005, 47 përqind e firmave të përfshira në sondazh (d.m.th BEEPS 2005) raportuan se mungesa e kualifikimit të duhur të krahut të punës përbën një pengesë. Kjo përqindje arriti në 58 përqind në vitin 2008. Së dyti, të gjitha vendet e EJK6-ës kanë si qëllim të bëhen pjesë e tregut të BE-së dhe të konvergojnë më nivelet e të ardhura në BE; ky proces do të kërkojë një rritje të shpejtë të produktivitetit, që do të vijë nga përmirësimi i kualifikimit profesional të krahut të punës.

Figura 1: Shpërndarja e firmave që e konsiderojnë aftësitë profesionale si kufizim “madhor” apo “shumë serioz”, 2008



Burimi: Llogaritjet e autorëve bazuar në BEEPS 2008.


Note: LI = ardhura të ulëta, MI = të ardhura të mesme, $x = \%$ e firmave (në vendet përkatëse) që konsiderojnë arsimin si një pengesë, Figura tregon të dhënat e marra nga raundi i katërt i BEEPS kryera në 2008-09, e cila mbulon rreth 11.800 ndërmarrje të në 29 vende.

njohuritë e duhura, a e kanë aftësinë për ta aplikuar dijen e marrë nga bankat e shkollës si edhe a kanë informacionin e duhur për të përfunduar detyrën e ngarkuar dhe për të zgjidhur problemet—kur ata largohen nga bankat e shkollës. Së dyti, të diplomuarve të sistemit arsimor në rajon mund t’u mungojnë aftësitë/kompetencat e nevojshme etike që nevojiten nga punëdhënësi si p.sh. qëndrimi ndaj punës dhe puna në ekip (shih Kutinë nr. 1 për llojet e kualifikimeve profesionale që kërkohen nga kompanitë).

Faktet gjithmonë e më shumë kanë treguar se firmat/kompanitë kërkojnë të punësojnë individë të cilët kanë jo vetëm kompetencat dhe dijet teknike dhe profesionale, por edhe që kanë aftësi të veçanta sjelljeje. Kështu, p.sh. sondazhet e kohëve të fundit të punëdhënësve në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (figura 2) tregojnë se firmat vlerësojnë këto lloj aftësish si dije apo aftësi njohëse (si p.sh. zgjidhja e problemeve).²¹

Për të kuptuar se për çfarë kualifikimi profesional dhe kompetencash shqetësohen firmat u zhvilluan edhe sondazhe të tjera në një numër vendesh. Në pari, fakti që firmat ankohen gjithmonë e më shumë në lidhje me mungesën e krahut të kualifikuar të punës mund të nënkuptojë disa gjëra: së pari, të diplomuarit mund të mos kenë kompetencat e duhura/nevojshme teknike për të bërë punën e ofruar nga punëdhënësi. Dhe kjo nuk është thjesht çështje e nivelit arsimor, me fjalë të tjera e përfundimit të një niveli të caktuar shkollor. Ajo është gjithashtu çështje që ka të bëjë me faktin nëse studentët e kanë kualifikimin e duhur për punën që kërkohet—a kanë


Figura 2: Aftësitë më të rëndësishme profesionale që ndihmojnë në punësim (% e firmave të pyetura), Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë.



Burimi: Jo thjesht diploma, por kualifikime profesionale.

Sipas një sondazhi tjetër të kryer nga ILO për punëdhënësit në Serbi u konstatua se firmat e manifakturës i konsideronin aftësitë ndërpersonale (dhe kualifikimin teknik) si më të rëndësishme sesa aftësitë bazike njohëse si p.sh. numërimi. Të pyetura në lidhje me kompetencat profesionale që ata i konsideronin si më të rëndësishme, firmat përmendën punën në ekip, komunikimin, aftësitë ndër-personale dhe përdorimin me efikasitet të materialeve/teknologjisë /pajisjeve, si elementë tepër të rëndësishëm për firmat që parashikonin rritje. Një model i ngjashëm vihet re midis firmave të shumicës. Njëkohësisht, sondazhi tregon se 40 përqind e krahut të kualifikuar të punës në tregti dhe 55 përqind e krahut të punës në sektorët e “proceseve & makinerive” konsideroheshin që nuk kishin aftësi të mjaftueshme profesionale nga i njëjti grupi i firmave të manifakturës. Mungesa tjetër u vu re në kompetencat që kishin të bënin me fleksibilitetin dhe punën në ekip (Figura 3).

Figura 3: Mungesë krahu i kualifikuar pune në disa profesione të prodhimit në Serbi



Burimi: ILO Sondazhi i Punëdhënësve Serbi, 2009.

Kutia 1: Aftësitë e larta për nevojat e punës në shekullin 21

Në ditët e sotme, termi “aftësi” përgjithësisht lidhet me aftësitë që kanë të bëjnë me shkathtësinë manuale –d.m.th aftësi dhe hijeshi në lëvizjet fizike – dhe me përdorimin e metodave, materialeve, instrumenteve të ndryshme. Këto aftësi rëndom asociohen më shkollat profesionale dhe me profesione specifike. Në raportin **Jo thjesht diploma, por kualifikime profesionale**, këto aftësi referohen si “aftësi teknike”.

Megjithatë, tashmë është një fakt i pranuar nga shumica që individët kanë nevojë për një grup më të gjerë aftësish për të qenë të suksesshëm në punë dhe në jetë. Rrjedhimisht, në raportin **Jo thjesht diploma, por kualifikime profesionale** përdorimi i termit “aftësi” është më i gjerë për të përshkruar tri lloje të veçanta aftësisht: (1) “konjitive”; (2) “jokonjitive” (apo socio-emocionale); dhe (3) aftësi teknike. Aftësitë konjitive janë aftësi që përfshijnë përdorimin e të menduarit logjik, intuitiv dhe krijues. Dhe aftësitë që lidhen më rëndom me aftësitë konjitive janë aftësi që kanë të bëjnë me aftësinë për shkrim e këndim dhe për zgjidhjen e problemeve.

Megjithatë ka fakte në rritje që flasin për rëndësinë e aftësive jokonjitive për të qenë të suksesshëm në jetë (shih: Banka Botërore 2011 për fakte të fundit nga Peruja). Në ditët e sotme, aftësitë jokonjitive shpesh quhen ndërpersonale, aftësi për jetën dhe lidhen ngushtësisht me ato që quhen “çështje karakteri”: “autorregullim”, vendosmëri, me aftësitë për vendim-marrje, aftësitë për të punuar në ekip dhe aftësitë për të caktuar objektiva jetësore dhe për të ruajtur ato gjatë gjithë jetës.

Aktualisht, teste të standardizuara me nxënësit e shkollave të mesme sigurojnë një matje të aftësive të tyre konjitive – si aftësi konjitive si p.sh. aftësia për të lexuar, por edhe aftësi të tjera konjitive të një niveli më të lartë si: të menduarit në mënyrë kritike dhe gjykimi analitik, por jo të aftësive për t’u përshtatur nga pikëpamja e sjelljes. Studime të kohëve të fundit në Peru tregojnë shembuj të përfshirjes së këtij testimi në sondazhet e zakonshme (shih Banka Botërore 2011b).


Burimi: Autorët bazuar tek OECD (1999a) dhe materialet që mund të gjenden në këto adresa: Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike në Zvicër (www.seco.admin.ch), Qendra Kombëtare Australiane për Kërkime të Arsimit Profesional (www.ncver.edu.au), Shoqata Amerikane për Trajnime dhe Zhvillim (www.astd.org).

Çfarë aftësish nuk arrijnë të ofrojnë institucionet arsimore dhe ato të trajnimit?

Nga sondazhet e firmave del qartë që nga pikëpamja e kërkesës ka një perceptim të mungesës së aftësive/kualifikimeve profesionale. Nga këndvështrimi i ofertës është edhe më i vështirë të përcaktohet me saktësi se ku po dështojnë institucionet arsimore dhe ato të trajnimit. Problem kryesor, që është një problem global, ka të bëjë me faktin që të dhënat arsimore kanë tendencë të përqendrohen tek sasia, si p.sh. numri i nxënësve që frekuentojnë shkollën dhe numri i nxënësve që mbarojnë shkollën, dhe jo tek aftësitë që studentët përftojnë (ose jo). Për më tepër, ka të dhëna mbi arritjet arsimore të popullatës së rritur, por jo mbi përvetësimin (ose jo) nga ana e tyre e aftësive teknike, konjitive dhe jokonjitive. Në rastet kur të dhënat ndërkombëtare krahasimore janë të disponueshme ato fokusohen tek cilësia e arsimit fillor apo tek vitet e para të arsimit të mesëm. Fokusi tek inputet dhe tek niveli i aftësive të të rinjve është në veçanti problematik duke qenë se shumë pak të rinj në rajon hyjnë në tregun e punës me një diplomë të mesme të ulët. Pjesa më e madhe e studentëve të EJL6-ës kanë përfunduar së paku diplomë të mesme të avancuar. Por pa një vlerësim në rang ndërkombëtar të aftësive dhe kualifikimeve profesionale të diplomantëve të shkollave të mesme dhe universiteteve është e pamundur të bëhet një kuantifikim i hendekut të kompetencave midis personave që kanë hyrë rishtas në tregun e punës në vende p.sh. si

Serbia dhe Sllovakia. Të dhënat që janë aktualisht të disponueshme dokumentojnë sa student përfundojnë shkollën në një vit të caktuar dhe jo çfarë ata u ofrojnë punëdhënësve si kompetenca.

Figura 2: Vitet e shkollimit për individët e moshës 25-34 vjeç në vendet e EJL6-së, 2006 (në përqindje)



Burimi: BERZH – Banka Botërore sondazhi i tranzicionit 2010

Shënim: Nuk ka të dhëna për Kosovën.

Mungesa e të dhënave përkatëse për studentët dhe performancën e tyre individuale është në veçanti akute në sektorin profesional për shkak të variacioneve të mëdha të shkollave profesionale dhe heterogjenitetit të tyre të mundshëm. Tendenca e të dhënave arsimor për t'u fokusuar tek sasia dhe jo tek cilësia dhe relevanca është gjithashtu e shprehur tek arsimi dhe trajnimi i të rriturve. Në rastin më të mirë, sondazhet aktuale në këtë sektor matin numrin e orëve të trajnimit dhe kurseve ku marrin pjesë individët apo nëse një firmë ofron trajnime. Por nuk ka të dhëna ndërkombëtare krahasimore ende për të bërë krahasimin e cilësisë apo rëndësisë të trajnimeve të tilla.

Po kështu, më lulëzimin e frekuentimit të universiteteve në të gjithë rajonin, mungesa e testeve që matin aftësitë profesionale që përftojnë studentët gjatë studimeve të tyre është një pengesë. Në këtë pikë, as studentët, as punëdhënësit dhe as politikë-bërësit nuk e dinë nëse studentët po përftojnë aftësitë dhe njohuritë e duhura gjatë viteve të shkollimit. Dhe askush nuk e di se ku në sistem, sipas fushës të studimit, llojit të universitetit - studentët janë në një kurbë të pjerrët mësimi krahasuar me vendet e tjera. Pjesërisht ky informacion ekziston për disa profesione të caktuara, aty ku vetë profesioni ka hartuar “provime profesionale” për certifikimin e diplomantëve të vet. Në shumë vende këto provime profesionale ekzistojnë për avokatët, mësuesit, mjekët dhe arkitektët. Megjithatë, në vendet e EEU6-së, rritja më e lartë e frekuentimit ka qenë në fusha për të cilat nuk ka provime për certifikimin profesional, si p.sh. në ekonomi dhe në biznes. Për më tepër, edhe këto “provime profesionale” kanë kufizimet e tyre përse i takon evidencave që gjenerojnë në lidhje me aftësitë profesionale: ato mbulojnë vetëm studentët që vendosin ta bëjnë provimin; dhe japin një rezultat në lidhje me aspektin kalon-s’kalon, dhe jo një vlerësim të përvetësimit nga çdo diplomant të kompetencave të dëshiruara (p.sh. në formën e një pikavarzhi nga 1-100).

Le të shohim shembujt konkretë të mëposhtëm në lidhje me mënyrën sesi hendeku i informacionit në lidhje me aftësitë kufizon aktorët kryesorë në ndërmarrjen e vendimeve të informuara dhe në përmirësimin e cilësisë së sektorit: Në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë ka 5 institucione arsimore publike dhe 15 institucione arsimore private të arsimit të lartë, nga të cilat 13 ofrojnë programe në ekonomi. Çdo aktor i interesit ka pyetje që nuk mund të trajtohen nga sistemi aktual i informacionit.

- Nga këndvështrimi i studentit: cili nga institucionet më vjen më shumë dhe më mirë në ndihmë për të përfituar aftësitë që më duhen për të qenë i suksesshëm? Pa këtë informacion, forca përzgjedhëse e studentëve është tejet e kufizuar.
- Këndvështrimi i punëdhënësit: a kanë të diplomuarit nga institucionet arsimore aftësitë/kualifikimet dhe kompetencat që i nevojiten firmës/kompanisë time?
- Këndvështrimi i institucioneve të arsimit të mesëm (që japin lëndën e ekonomisë): si krahasohet programi lëndor i “ekonomisë” që japim ne me programe të tjera të “ekonomisë”? A po marrin studentët tanë aftësitë e duhura për përvetësimin siç duhet në lidhje me kompetencat kryesore në këtë fushë ashtu si institucionet e tjera? Në rast se është kështu, si mund t’ua tregoj këtë studentëve të ardhshëm dhe punëdhënësve në potencë të studentëve të mi?
- Këndvështrimi i politikë-bërësve: si krahasohet performanca me fushat e tjera (përsa i takon cilësisë dhe relevancës të arsimit që ofrohet)? Cilat institucione kanë mësimdhënie të mira dhe cilat jo? Cilat janë institucionet që kanë më shumë nevojë për mbështetje?

Ndezja e dritave

Për t’u dhënë politikë-bërësve informacionin e nevojshëm për përpilimin e politikave më të mira, si edhe me qëllim që studentët të shndërrohen në një forcë më të madhe përzgjedhëse, libri “Jo thjesht diploma, por kualifikime profesionale” rekomandon mënyrat e mëposhtme për “Ndezja e dritave”.

- Vijimin e pjesëmarrjes në vlerësimet ndërkombëtare (si p.sh. TIMSS²³ dhe PISA²⁴)
- Zgjerimi i përdorimit të vlerësimeve kombëtare të studentëve, vendosja e më shumë theksi tek evidentimi i meritave dhe mangësive të sistemeve arsimore dhe të trajnimit përkundrejt thjesht testimit të studentëve (p.sh. a ka grupe të caktuara studentësh që në mënyrë sistematike nuk ia dalin të përftojnë nivelin e dëshiruar të kompetencave profesionale?).
- Futja e studimeve për të ndjekur të diplomuarit për të kontrolluar dhe konstatuar nëse të diplomuarit janë në gjendje të gjejnë një vend pune (Kutia 2)
- Futja e testeve të aftësive profesionale të studentëve në universitete.

Shtimi i të dhënave në vetvete nuk do të rezultojë në politika më të mira; informacioni duhet analizuar, shpërndarë dhe përdorur për hartimin e politikave. Vendet që kanë qenë të suksesshme në mbledhjen e të dhënave në lidhje me performancën e studentëve që përdoren për hartimin e politikave, si p.sh. Singapori, Polonia apo Kili, të cilat ofrojnë mësim për të tjerët. Disa prej këtyre mësimëve janë:

- Ndërtimi i kapaciteteve teknike (vendase) për hartimin dhe analizimin e testeve. Në Singapor, këto kapacitete u krijuan në mënyrë graduale përmes një bashkëpunimi të ngushtë me stafin kërkimor-shkencor të universitetit të Kembrixh-it, të cilët si fillim hartuan dhe zhvilluan këto teste. Në Kili, analizat fillestare u bënë mbi baza pilote nga një universitet lokal. Vetëm gradualisht funksioni i vlerësimit i kaloi një agjencie autonome.
- Zgjerimi i aksesit ndaj grupit të të dhënave për inkurajimin e kërkuesve shkencorë në evidentimin e meritave dhe mangësive. Kështu, p.sh. OECD-ja i bën publike të gjitha të dhënat e PISA-s për t’u marrë nga internet në adresën (<http://pisa2009.acer.edu.au/>; dhjetor 2010).

²³ Tendencat në Studimet Ndërkombëtare Matematikore dhe Shkencore.

²⁴ Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve (www.pisa.oecd.org/)

- Ndryshimi i politikave për t'u dhënë peshë të dhënave, si p.sh. bërja e përmirësimit të rezultateve arsimore të studentëve një komponent për vlerësimin e mësuesve dhe shkollës (në rast se rezultatet e vlerësimeve nuk kanë impakt, qoftë të drejtpërdrejtë ose jo, mbi politikat dhe karrierën e individëve është shumë e vështirë të mobilizohen dhe ruhen burimet e mbajtjes së qendrave të vlerësimit dhe të trajnohen personat për analizimin e rezultateve).
- Shpërndarja aktive e rezultateve në të gjitha nivelet e sistemit arsimor për të garantuar që hartimi e kurikulave dhe trajnimi i mësuesve mund të influencohet nga meritat dhe mangësitë e evidentuara nga rezultatet e testit.

Kutia 2: A po gjejnë vende pune të diplomuarit? Futja e studimeve për të ndjekur të diplomuarit në Rumani dhe Hungari

Dy janë vendet evropiane që kanë ecur përpara në lidhje me studimet ndjekëse, Hungaria dhe Rumania. Faktikisht, këto studime po shndërrohen në një element esencial të menaxhimit të sistemit të arsimit terciar në këto vende. Në Hungari, viti 2010 shënoi vitin e parë ku u prodhuan rezultate të "Sistemit të ri për Ndjekjes së Karrierës të të Diplomuarve" (mbulon të diplomuar nga 25–30 institucione). Në Rumani, të dhënat nga një sondazh në lidhje me të diplomuarit do të bëhen të disponueshme gjatë vitit 2011. Në atë kohë, hartuesit e politikave do të kenë në dorë rezultate nga sondazhet për studentët që janë diplomuar në periudhën 2008–09 (d.m.th. 12 muaj pasi kanë mbaruar shkollën), si edhe për studentët që janë diplomuar në vitet 2004–05 (d.m.th. pesë vjet pas përfundimit të shkollës). Ashtu si në rastin e Hungarisë, studimet e ndjekjes së diplomuarve në Rumani po financohet nga program i Fondeve Sociale i BE-së.

Hungaria po përparon me shpejtësi në lidhje me studimet e ndjekjes së diplomuarve dhe kjo për disa arsye. Së pari, hartuesit e politikave në nivel qendror po u ushtrojnë trysni institucioneve terciare që të nisin t'i mbledhin këto të dhëna. *Ligji hungarez i vitit 2005 për arsimin e lartë e bën të detyrueshëm për çdo universitet dhe koleg organizimin e sondazheve për të diplomuarit e vet.* Gjithashtu, pushteti qendror i ka bërë studimet e ndjekjes së diplomuarve pjesë të debateve që lidhen me sigurimin e cilësisë, me disponueshmërinë e këtyre sondazheve që tani (ose më vonë) do të kushtëzojnë marrëveshjet e akreditimit të institucioneve. Gjithashtu, qeveria po përdor pushtetin e financave duke i kushtëzuar të dhënat e studimet e ndjekjes së diplomuarve (apo disponibilitetin e tyre) me marrëveshje tre vjeçare financimi. Së dyti, vetë institucionet e arsimit të lartë në Hungari i konsiderojnë të dhënat e këtyre sondazheve si të dobishme për një mori arsyesh: (1) ato duan informacion nga tregjet e punës për t'u ardhur atyre në ndihmë për përpilimin e programeve më të mira; (2) të dhënat mund të përdoren në marketing; (3) të dhënat janë të vlefshme për garantimin e cilësisë së brendshme; dhe (4) studimet e ndjekjes së diplomuarve janë një ndër instrumentet për angazhimin dhe forcimin e rrjetit të të diplomuarve të dikurshëm (alumni).

Po kështu, disa vende të OECD-së ofrojnë shembuj të përdorimit të studimet e ndjekjes së diplomuarve. Norvegjia rezulton të ketë ndjekjen të këtyre të dhënave qysh nga viti 1972; Italia qysh nga viti 1998 dhe Holanda qysh nga viti 1989. Në Hollandë, pothuajse të gjithë të diplomuarit nga institucionet e arsimit të lartë janë objekt i sondazheve një vit e gjysëm pasi kanë përfunduar shkollën e lartë. Sondazhi mbledh informacion gjithëpërfshirës mbi një gamë çështjesh të ndryshme, duke përfshirë informacion në lidhje me tranzicionin nga shkolla në punë (duke bërë pyetje të tilla si: Sa kohë t'u desh të gjeje një punë?); lloji dhe cilësia e punësimit, në rast se ka të tillë (si p.sh. sektori dhe kërkesat për kualifikim profesional); dhe sat ë kënaqur janë studentët me arsimin që kanë marrë (a u ka garantuar ai një bazë të shëndoshë për të hyrë në tregun e punës? A i ka ndihmuar në zhvillimin e aftësive të duhura profesionale? A u ka garantuar balancën e duhur midis teorisë dhe praktikës?).

Tabela 1 tregon llojin e informacionit që mblidhet nga këto sondazhe.

Kutia 2: vazhdim

Tabela 1: Informacioni i mbledhur nga studimi i ndjekjes të diplomuarve në Hollandë, 2007

	Kohëzgjatja e kërkimit për punë (në muaj)	Punësimi i plotë (%)	Kontratë e pakufizuar	Paga mujore bruto Euro	Drejtuese ose profesionale (% ISC01 ose 2) Mean	Përdorimi i lartë i aftësive {%}	Kënaqësi e lartë në punë	
	Mesatarja	Mesatarja	Mesatarja	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mesatarja	Mesatarja
Shkenca dhe matematikë	0.7	38.4	45.6	2499	2429	83.6	71.0	77.5
Mjekësi	0.7	79.0	41.0	2904	2783	82.6	78.9	81.7
Inxhinieri	1.0	94.4	66.2	2772	2631	87.4	75.2	72.8
Ekonomiks	10	96.1	71.3	2954	2783	70.3	65.6	70.1
Juridik	1.2	92.7	57.5	2864	2732	87.8	66.0	70.2
Arte	1.2	59.1	43.0	2188	2226	66.0	50.4	61.3
Shkenca sociale	1.3	60.6	45.4	2317	2350	72.0	63.9	65.4
Bujqesi	1.5	86.7	45.6	2137	2328	84.2	73.2	71.2

Burimi: Tabela siguruar nga Qendra e Kërkimit për Arsim dhe Tregut të Punës (ROA), Holandë, 2008, me kërkesën e autorit

Speciale #2.

A mund ta rrisë Bashkëpunimi Rajonal Kontributin e R&D dhe Inovacionit ndaj Zhvillimeve Ekonomike në vendet e EJL6-ës?²⁵

Vendet e EJL6-ës kanë një grup sfidash dhe mundësish të përbashkëta në lidhje me punën kërkimore dhe zhvillimin (R&D) si edhe me inovacionin. Në këtë dokument hulumtohet kontributi i R&D dhe politikat novatore në kuadrin e zhvillimit afatgjatë, duke theksuar përfitimet e një qasjeje rajonale për maksimizimin e mundësive në këtë fushë.

²⁵ Ky dokument u përgatit nga Dragana Pajovic (analiste, ECSPF) dhe Paulo Correa (krye-ekonomist, ECSPF). Dokumenti bazohet në Raportin fillestar: *Strategjia rajonale K&Zh për Inovacion në Ballkanin Perëndimor*. Banka Botërore, qershor 2011. Mimeo.


Speciale #2.

A mund ta rrisë Bashkëpunimi Rajonal Kontributin e R&D dhe Inovacionit ndaj Zhvillimeve Ekonomike në vendet e EJL6-ës?

Përse nevojiten R&D dhe politikat novatore?

Për ruajtjen e rritjes ekonomike afatgjatë, vendet e EJL6 do të duhet të nxisin ristrukturimin industrial me qëllim nxitjen e produktivitetit. Një nga mënyrat për ta bërë një gjë të tillë është përmirësimi të politikave R&D me qëllim nxitjen e inovacionit. Ristrukturimi industrial dhe inovacioni do të shtojnë sofistikimin dhe vlerën e produkteve industrial dhe do të risin sofistikimin e eksporteve. Deri tani nuk ka ndodhur kështu dhe siç tregohet në Figurën 1, përqindja e teknologjisë së lartë në totalin e eksporteve është në veçanti e ulët në Maqedoni, Bosnje dhe Shqipëri.

Figura 1: Eksportet e teknologjisë së lartë (përqindja e eksporteve), 2009



Burimi: UN Comtrade, WDI, OECD

Kutia 1: Ndikimi i R&D mbi Rritjen dhe Eksportet: Mësime nga vendet fqinje

Një studim i kohëve të fundit i Bankës Botërore * bën një vlerësim të ndikimit të arritjes së objektivit prej 3 përqind R&D si përqindje e PBB-së, e përcaktuar nga Axhenda e Lisbonës (dhe të konfirmuar nga Evrope 2020) dhe nga eksportet e vendeve të përzgjedhura. Efektet më të mëdha parashikohen për Bullgarinë, Rumaninë dhe Kroacinë – gjë që reflekton distancën e këtyre vendeve ndaj objektivit të lartpërmendur. Kështu, p.sh. në rastin e Kroacisë dhe Bullgarisë, arritja e objektivit prej 3 përqind do të rriste eksportet dhe PBB-në me afërsisht 13 përqind, deri në vitin 2025 (Tabela 1).

Gjithashtu studimi arriti në konkluzionin që midis pesë objektivave të Axhendës së Lisbonës (R&D, pjesëmarrja në krahun e punës, plotësimi i tregut për shërbime, reduktimi i barrës administrative dhe arsimit), arritja e objektivit të pjesëmarrjes në krahun e punës (75 përqind) dhe R&D (3 përqind) do të gjeneronte impaktin më të madh tek PBB-ja dhe eksportet për Bullgarinë, Rumaninë dhe Kroacinë.

* Banka Botërore (2009): Raporti i BE-së Konvergjencja e Kroacisë: Arritja dhe mbajtja e normave të larta të rritjes ekonomike. Raporti Nr 48879 - HR.

Tabela 1: Ndikimi i Axhendës së Lisbonës në objektivat e Kërkim&Zhvillimit 2025

	PBB	Eksportet
Bulgaria	13.1	8.3
Kroacia	6.0	12.9
Hungaria	6.4	8.0
Polonia	5.5	8.5
Rumania	11.7	13.5
Sllovakia	8.9	10.4
Sllovenia	6.9	10.5

Note: Simulimet bazuar në modelin Scan Botëror. Numrat janë ndryshimet kumulative kur arritjen e objektivit prej 3 Përqind në krahasim me bazë në vitin 2025.

R&D nuk janë të mjaftueshme, dhe as të nevojshme për inovacionin, por rritja e shpenzimeve për R&D në nivel firme shpesh çon në produktivitet më të lartë, probabilitet për inovacion dhe predispozitë për eksporte. Shpenzimet e firmave për R&D janë po ashtu të rëndësishme për të rritur “kapacitetin absorbues” të sektorit të ndërmarrjeve, d.m.th kapacitetin e sektorit të ndërmarrjeve për t’iu përshtatur dhe për të përshtatur teknologjitë e huaja dhe përfitimet nga efektet pozitive anësore të investimeve të huaja

direkte. Ndërsa vendim për të investuar në R&D dhe novacione varet nga një numër faktorësh që janë specifike sipas industrive dhe vendeve, politikat e duhura R&D mund t'i bëjnë firmat të investojnë më shumë në R&D, të përshpejtojnë transferimin e teknologjive dhe të lehtësojnë bashkëpunimin midis organizatave publike kërkimore dhe sektorit të ndërmarrjeve.

Cilat janë sfidat?

Politikat për R&D përfaqësojnë një nga fushat ku vendet e EJL6-ës kanë patur një progres të ngadaltë gjatë periudhës së tranzicionit. Sistemet Kombëtare të Inovacionit mbetën të shpërfillura dhe vuajtën nga reformat e lëna në mes nga e kaluara. Po kështu, shpenzimet në agregat për R&D janë krahasimisht të ulëta në pjesën më të madhe të vendeve të EJL6-ës. Po kaq i rëndësishëm është fakti që këto shpenzime kanë tendencë të prodhojnë rezultate të kufizuara shkencore dhe ekonomike duke qenë se shpenzimet janë kryesisht të përqendruara në sektorin publik dhe pak, ndofta dhe aspak, nga rezultatet e punës kërkimore komercializohen. Për më tepër, bashkëpunimi me sektorin privat është në nivele shumë të ulëta (Figurat 2a dhe b). Si konkluzion, dihet, kur ato krijohen, nuk do të vihen në përdorim nga pikëpamja ekonomike. Me qëllim përmirësimit e impaktit të politikave R&D, vendet e EJL6-ës duhet të përmirësojnë cilësinë e shpenzimeve publike për R&D.

Figura 2a: Shpenzimet bruto për K&Zh dhe PBB për frymë, 2008
(ose të dhënat më të fundit të disponueshme)






Figura 2b: Shpenzimet e K&Zh sipas grupeve të performancës, 2008 (ose më të fundit të disponueshme)




Burimi: UNESCO & OECD STI 2010/1 *të dhëna të pjesshme për BIH **HE: Arsimi i lartë ***n.s.e. e paspecifikuar

Figura 3: publikimi i dokumenteve për mln banore



Burimi: Banka Botërore, Unesco

Figura 4: përqindja e diplomave në degët e shkencës apo inxhinierisë, 2009, %



Burimi: UNESCO

Rezultatet e dobëta shkencore (nivel i ulët citimesh, aplikimesh të patentave dhe patentave të lëshuara) në vendet e EJK-ës janë rezultat i akordimit të burimeve publike që nuk janë të bazuara tek performanca, por tek të ardhurat për frymë. Burimet kërkimore vetëm kohët e fundit kanë nisur të akordohen mbi baza më konkurruese, por ende nuk kanë hyrë “kontratat e performancës”. Nga ana tjetër, numri i publikimeve, si përqindje e totalit të popullsisë ka ardhur duke u rritur nga viti në vit, në veçanti në Serbi (Figura 3).

(i) Një faktor tjetër që përcakton performancën shkencore është disponibiliteti i stafit R&D dhe punonjësve shkencorë. Vendet e EJK-ës kanë përjetuar fenomenin e largimit të trurit gjatë dy dekadave të fundit. Kështu, p.sh. në Bosnje-Hercegovinë, mbi 60 përqind të punonjësve shkencorë, të stafit akademik të universiteteve dhe punonjësit kërkimorë janë larguar nga vendi gjatë 10 viteve të fundit dhe kjo situatë është shumë e ngjashme edhe në Shqipëri. Shqipëria u përpoq ta trajtonte këtë çështje përmes

zhvillimit të një programi të quajtur Brain Gain (2006-2011) në bashkëpunim me PNUD-in, i cili kishte si synim përfshirjen e akademikëve, sektorit privat dhe aktorëve të tjerë të interesit në përdorimin e ekspertizës të diasporës shkencore shqiptare. Nga ana tjetër, përqindjet e diplomimit tregojnë tendenca pozitive në fushat e inxhinierisë dhe shkencave, në një farë mase, kur krahasohen me mesataren e EU-27-ës (Figura 4).


(ii) Disponibiliteti i pajisjeve modern për punën kërkimore-shkencore është një tjetër problem përse i takon rajonit. Objekte të mëdha infrastrukturore të ndërtuara për t'i shërbyer ish Jugosllavisë ndonjëherë janë shumë të mëdha për t'u futur në punë në tregun e ri kombëtar dhe me kosto të lartë mirëmbajtjeje për buxhetet e vendeve përkatëse. Si rrjedhojë ato bëhen pre e shkatërrimit. Aksesit ndaj informacionit dhe teknologjive (ICT) gjithashtu ndryshon ndjeshëm nga vendi në vend brenda për brenda rajonit. Ndërsa Serbia dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë krahasohen relativisht mirë me vendet e BE-së, Shqipëria dhe Bosnje-Hercegovina nga ana tjetër janë mbrapa.

Program i reformave

(iii) Vendet e Ballkanit Perëndimor do të duhet të trajtojnë disa sfida me qëllim çlirimin e potencialit novator, ku ndër më të rëndësishmet përfshihen: (i) shtimi i produkteve shkencore (publikime; citime; patenta etj.); (ii) përshpejtimi i komercializimit të punës kërkimore dhe rritja e bashkëpunimit me sektorin e biznesit; dhe (iii) nxitja e niveleve më të larta të investimeve private në R&D. Si mund të arrihen këto objektiva dhe përse do të ishte e dobishme një qasje rajonale?

(iv) Rritja e produkteve shkencore. Në kuadrin e burimeve të pakta, rritja e produktit shkencor do të kërkonte një menaxhim më të mirë të burimeve financiare dhe njerëzore. Një nga rrugët për ta arritur një gjë të tillë është përmes futjes së kontratave me bazë performance për akordimin e burimeve për organizatat kërkimore-shkencore publike. Këto përpjekje reformash kanë nisur në disa prej vendeve të EU10-ës siç është Rumania, dhe vendet e EJK6-ës mund të mësojnë nga përvoja e të tjerëve. Një mënyrë tjetër për të nxitur eficiencën është përmes rritjes së autonomisë fiskale dhe fleksibilitetit për menaxhimin e burimeve njerëzore të organizatave publike kërkimore-shkencore. Kjo duhet shoqëruar më një modernizim të politikave të burimeve njerëzore në favor të arritjeve shkencore dhe me një krijim të mundësive për kërkuesit e rinj shkencorë (në vend të praktikës aktuale të promovimeve automatike bazuar kryesisht mbi “vitet e punës”). Rritja e burimeve financiare për punën kërkimore mbi baza konkurruese është një iniciativë tjetër që inkurajon rritjen e rezultateve. Të gjitha masat e lartpërmendura mund të bëhen pjesë e legjislacioneve modern që rregullojnë punën kërkimore-shkencore, sic ka qenë rasti në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Kroaci.

Figura 5: Komercializimi i punës kërkimore në sektorin publik-pamje skematike



(v) Përshpejtimi i komercializimit të punës kërkimore-shkencore dhe rritja e bashkëpunimit me sektorin e biznesit. Ndikimi i shpenzimeve R&D nga sektori publik mbi shpenzimet për zhvillimin ekonomik varet nga mënyra sesi rezultatet shkencore dhe kapacitetet e punës kërkimore-shkencore komercializohen në formën e licencave; problemi nuk ka të bëjë me ekzistencën apo jo të

komercializimit, por me faktin nëse ekzistojnë kushtet për një proces sistematik (përkundrejt gjërave rastësore). Pjesën dërrmuese të herëve, komercializimi nuk është rrjedhojë natyrale e punës kërkimore. Shumica e zbulimeve kërkojnë zhvillime të mëtejshme për të arritur një stad të marketueshëm. Punonjësve shkencorë shpesh u mungon kapaciteti për ta parashikuar një potencial të tillë dhe nuk duan të devijojnë nga puna kërkimore thjesht akademike që u sjell atyre mundësi më të mira për të bërë karrierë. Një tjetër pengesë është arritja e përputhjes midis vetë shpikjes dhe kërkesës nga tregu, si edhe formati i komercializimit (figura 5). Sigurimi i tregtimit në rajon do të kërkonte, ndër të tjera: (i) një kuadër ligjor që e kalon rolin e menaxhimin të pronësisë intelektuale (IP) të punës kërkimore shkencore tek universitetet; (ii) një regjim stimujsh që inkurajon punonjësit kërkimorë-shkencorë të përfshihen në procesin e komercializimit, si p.sh. vendosja e një kompensimi minimal financiar dhe marrja në konsideratë e rezultateve të komercializimit për arritje të mëtejshme në karrierë; dhe (iii) zhvillimi i organizatave të specializuara në menaxhimin e IP, si p.sh. zyrat për transferimin e teknologjive.

(vi) Nxitja e niveleve më të larta të R&D në sektorin privat dhe krijimi i kompanive novatore. Aktiviteti i punës R&D në një vend të caktuar influencohet nga një numër faktorësh, duke përfshirë shkallën e specializimit ekonomik, nivelin e konkurrencës dhe aksesin ndaj financave. Specializimi ekonomik është një faktor relevant sepse sektorë të tillë si: bioteknologjia dhe IT mund të jenë më shumë të interesuara për të investuar në R&D sesa bie fjala industria tekstile apo ajo e veshmbathjeve. Ndërsa, rritja e konkurrencës mund të nxiste R&D dhe inovacionin. Në kuadrin e reformave strukturore këto diferenca mund të nxisin konkurrencën dhe mund të luajnë një rol të rëndësishëm për ekonominë në tranzicion. Aksesin ndaj financimeve të huaja është një tjetër faktor i rëndësishëm për zgjerimin e R&D. aksesin ndaj kredive për aktivitetet e zakonshme çliron burimet e brendshme që ato të investohen në biznese më me risk sic janë R&D dhe inovacioni. Në këtë kontekst, zhvillimi i një sërë fazash mbështetjeje direkte apo indirekte për financimin e inovacionit, disa prej të cilave do të kërkojnë shkallë të mjaftueshme për të lejuar një menaxhim të duhur të riskut mund të ishin ndërhyrje të dobishme për nxitjen e biznesit R&D. Mbështetja direkte do të përfshinte programe publike që do të mbështesnin fazat e ndryshme të zhvillimit të inovacionit përmes SMEve apo firmave të reja – nga grantet deri tek zhvillimi i një prove koncepti; tek grantet apo huatë e kushtëzuara për zhvillimin e prototipeve, si edhe financime të llojit kapital sipërmarrës për financimet në fazat e hershme dhe për firmat e reja. Iniciativa të rëndësishme në këtë drejtim po përpilohen nga Serbia. Disa nga këto programe kanë kohë që zhvillohen në vende fqinje sic është Kroacia, ku vlerësimet fillestare flasin për ndikime pozitive. Mbështetja indirekte – në formën e heqjes së taksave për R&D, mund të jetë relevante për firmat e mëdha, por është një formë tjetër e njohur e mbështetjes publike që nuk është përdorur sa duhet në rajon.

Përse është me rëndësi bashkëpunimi rajonal?

(vii) Programi i reformave i përshkruar më sipër është i ndërlikuar dhe i kushtueshëm dhe një mënyrë për reduktimin e kostos dhe rritjen e ndikimit të reformave do të ishte përmes bashkëpunimit rajonal. Së pari, një program rajonal reformash mund të shërbejë si një angazhim i besueshëm për zbatimin e reformave në këtë fushë. Angazhimet ndërkombëtare shpesh e kanë luajtur një rol të tillë në zbatimin e reformave – si p.sh. në rastin e harmonizimit të rregulloreve të tregtisë në vendet e BE-së. Në një deklaratë të përbashkët (Sarajevë, prill 2009), Ministrat e vendeve të EJK-ës përgjegjëse për Shkencën dhe Kërkimet Shkencore nisën një përpjekje të përbashkët për zhvillimin e një Strategjie Rajonale për Punën Kërkimore dhe Zhvillimin për Ballkanin Perëndimor, me qëllim krijimin e një koalicioni të gjerë politik – që duhej të përfshinte edhe organizatat kombëtare -- për të forcuar politikën inovatore në rajon. Bashkëpunimi rajonal afatgjatë do të kontribuojë për ta bërë R&D një veprim prioritar në programet e politikave kombëtare.

Një mënyrë tjetër sesi bashkëpunimi rajonal mund t'i vijë në ndihmë R&D është përmes shmangies së fragmentarizimit dhe/ose mbivendosjeve të shpenzimeve, duke sjellë një përmirësim të cilësisë së shpenzimeve publike në R&D dhe në impaktin e tyre të përgjithshëm në ekonomi. Qasje e tillë rajonale

duket veçanërisht i përshtatshëm në fushat ku asnjë nga vendet nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm dhe burime për të adresuar sfidat e ndeshura dhe një shembull i tillë është ndryshimi i klimës.²⁶ Fusha të mundshme për bashkëpunimin përfshijnë:

- Nxitjen e krijimit të qendrave konkurruese rajonale të ekselencës në fusha me interes strategjik për rajonin;
- Nxitjen e zhvillimit të infrastrukturave rajonale kërkimore-shkencore, aksesit të hapur ndaj objekteve pan-Evropiane kërkimore-shkencore me interes të përbashket, si në rastin e teknologjive të pastra;
- Nxitjen e potencialit të shkencëtarëve të rinj përmes mbështetjes së zhvillimit të karrierës dhe krijimit të kushteve të favorshme për të mbështetur përpjekjet e tyre kërkimore-shkencore dhe për të mundësuar trajnimin, lëvizjen dhe bashkëpunimin në rajon;
- Forcimin e potencialit dhe kapaciteteve të vendeve të EJK6-ës për të marrë pjesë plotësisht në programet dhe iniciativat evropiane si p.sh. EC Framework Program No. 7, EUREKA (programi i SME-ve) dhe program për Bashkëpunim në Shkenca dhe Teknologji (COST) që nxisin rritjen e përfshirjes së sektorit të biznesit, kryesisht të SME-ve;
- Nxitjen e instrumenteve financiare rajonale në fazat e hershme, duke përfshirë një fond kapitali sipërmarrës që do të funksionojë në nivel rajonal, sic është ilustruar nga iniciativa e Serbisë për krijimin e një enti mbarë-rajonal për financimin në fazat e hershme.

²⁶ Vendet e rajonit SEE6 janë përdorues intensive të karbonit dhe energjisë. Në të njëjtën kohë, rajoni është identifikuar si një nga fushat në botë me potencial për Kapjen dhe Ruajtjen e Karboni. Bashkëpunimit rajonal për minimizimin e karbonit K&Zh do të jetë e nevojshme për të shfrytëzuar sinergjitë dhe fondet e levave në dispozicion.